

*Vlora Banushaj Krasniqi*

# IMAGJINATA VS

Vlora Banushaj Krasniqi u lind më 3.11.1973 në Pejë. Shkollën fillore dhe të mesmen i mbaroi në Klinë, ndërkaq studimet universitare i vazhdoi në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ku edhe diplomon në vitin 2001. Provimin e jurisprudencës e përfundoi në vitin 2003.

Nga viti 2005 deri në vitin 2010 ka punuar në Prokurori (atëkohë të quajtur Prokuroria Publike e Qarkut në Pejë), në pozitën e bashkëpunëtores profesionale. Në vitin 2010 emërohet Prokurore në Prokurorinë Themelore në Pejë, ku punoi deri në vitin 2013. Në vitin 2014 emigroi në Zvicër, ku jeton e vepron dhe sot e kësaj dite. Në vitin 2019 regjistroi studimet Master of Law në Universitetin e Freiburgut (Zvicër) ku edhe po i vazhdon studimet...

Me krijimtari letrare ka filluar të merret që në moshën e re. Është shpërblyer disa herë për poezitë e saj. Ka botuar shkrime në revistën "Teuta", në gazetën "Bota sot" dhe në shumë faqe interneti.


"Imagjinata VS" është libri i dytë i saj.

IMAGJINATA VS

Vlora Banushaj Krasniqi



KREUZLINGEN 2019

A close-up portrait of a woman with long, dark, wavy hair. She is looking directly at the camera with a slight smile. She is wearing a plaid shirt with red, grey, and white patterns. The background is bright and slightly blurred, suggesting an outdoor setting.

**Vlora BANUSHAJ KRASNIQI  
IMAGJINATA VS**

**Biblioteka: „SA-KRA”**

[www.sa-kra.ch](http://www.sa-kra.ch)



**Redaktor:**

**Përparim HYSI**

**Lektor/ Recensent:**

**Xhevahir CIRONGU**

**Kopertina:**

**Sabir KRASNIQI**

**© 2019**

**Vlora BANUSHAJ KRASNIQI**

**IMAGJINATA VS**

**KREUZLINGEN  
NËNTOR 2019**



## **„GJEOGRAFIA LETRARE“ E VLORA BANUSHAJ KRASNIQI**

Sapo mbarova së lexuari librin „Imagjinatë VS“ të VLORA BANUSHAJ-KRASNIQI dhe, i impresionuar nga temat që lëvron në këtë libër, po jap përshtypjet e mia.

Titulli që është fare simbolik dhe unik, të grishë të futesh në „hartën gjeografike“ të „vizatimeve letrare“ të autores. Imagjinata, si proces psikik, e ndihmon njeriun që të pasurojë bagazhin e dijeve dhe, në një farë mënyre, është një lloj gjimnastike e mendjes. Një psikiatër si FRITZ PEARLS e përkufizon imagjinatën si „një aktivitet mendor që më kursen kohë“. Sipas psikologëve të të gjitha disiplinave njerëzore, është arritur në një përfundim: imagjinata luan rol parësor në të gjithë aktivitetin krijues të njeriut. Nuk është se e teprojmë, po të themi që, mes të tjerëve, DANTE i detyrohet madhësisë, pothuaj hyjnore, të imagjinatës. Ose dhe ca më tej: OSCAR WILDE thotë: „Imagjinata i është dhënë njeriut për ta kompensuar për atë që nuk është dhe, duke i dhënë një sens humori, si për ta ngushëlluar, për atë që është“.

NAPOLEON HILL, duke folur për imagjinatën, thotë se „ajo të bën më syçelët“. Mund të vazhdoja edhe më për imagjinatën dhe, në po e

ndërpres këtu, dua si e si që t'ia marrë disi „kalanë përbrenda“ autores, për këtë titull kaq sinjifikativ që të futë në hamendësime racionale apo dhe iracionale, ndonjëherë, për këtë lloj titulli për librin e saj.

Libri i VLORA BANUSHAJ-KRASNIQI „Imagjinata VS“ është gati-gati një „libër xhepi“, por që ta „shqyen xhepin“. Unë, në gjykimin tim relativ, i quaj „vizatime letrare“. I quaj kështu se janë impresione të autores që, ngaqë nuk i mban dot për vete, na i dhuron gratis dhe pa na kërkuar „doganë“. Të shkruarit, zakonisht, nis si një ëndërr, por kjo „ëndërr“ prishet nëse nuk arrin atë që ke për qëllim. Dhe pyetjes a ia ka arritur autorja që „ëndërrën“ ta bëjë zhgjëndërr apo të vërtetë, unë me plot gojën shkruaj e them: - PO. Jo vetëm ia ka arritur, por me kumtet e bardhë që përcjell, është unike dhe si një përjashtim i bukur.

Imagjinata është si zjarri që nuk mund të shuhet kurrë, thotë GAIZA MAZZUCCO. Dhe kështu ndodh dhe me këtë libërth të vogël me vlerë të madhe. Po të marrësh „vizatimin e parë letrar të saj“, „Në prag të Vitit të Ri“ (maj-dhjetor 2009), gjen një përshkrim sa me penë, aq dhe me penelin e një piktori. Muajt e atij viti kalendarik, sikur bëjnë „paradë“ para syve të lexuesve dhe me një sy vëzhgues, gjen cingërimat e të ftohtat e dimrit, por, ngaqë autorja ka të drejtën e patjetërsueshme të të shkruarit, u jep edhe këtyre muajve attribute sipas imagjinatës së saj: si, për t'u bindur paksa ju që mund të lexoni këtë ese modeste

timen, shihni si thotë autorja: Janari -një urë miqësie; shkurti -vallëzim zemrash! Mars -besim jete! Prill-maj: veç dashuri e gëzim... dhe, për mos të vazhduar me atributet e muajve të tjerë, në gjykimin tim, arrin në një emërues të përbashkët: -Dashuria e Zotit e mbush shpirtin tim. Por unë shkoj dhe më tej: në këtë „vizatim letrar“, gjen peizazhet e MIOS; të verdhën dhe okrën e VAN GOGHUT dhe, po të ishte gjallë, „Kardinali i kuq“, VIVALDI do përgatiste një „kantantë“ si me „Katër stinët“. „Kuqalashi“ i famshëm ka ndërruar jetë në vitin 1741 dhe mua, ngaqë më ka zënë „sindroma e Stokholmit“ me këtë „Imagjinatën“, nis dhe unë imagjinatën time. Ka vdekur VIVALDI, por unë njoh një „dirigjent shëtitës“, si gjermanin JAMES LASTI dhe po e luan ai këtë lloj muzike, por dorëzohem me dhimbje: paska ndërruar jetë në vitin 2015. Pra, ëndrra ime u prish, por nuk priset mendimi im pozitiv për autoren.

Nëse NËNË TEREZA thoshte: „Paqja fillon me një buzëqeshje“, VLORA BANUSHAJ-KRASNIQI, bën një shkrim të gjatë, me titull: “Në mbretërinë e trëndafilave”. Këtu në analogji me atë që thotë NËNË TEREZA, thotë një metaforë, gati hiperbolë: “Jam strehuar tek buzëqeshja!” Apo më tej: „...e dëgjoj gjuhën hyjnore të trëndafilatit“ dhe në fund ajo thirrje aq e bukur dhe aq domethënëse; “Sa më shumë rrugë trëndafilash paçi ju, o njerëz të mirë!”



Dhe tek kalon nga proza në poezi, (sado që proza e saj është si poezi) dhe krijon me shpirtin e saj binjak, Sabir Krasniqin, shkruan poezinë „Kopshti i miqësisë së artë“. Edhe këtu plot kumte të bardha, si: „Parajsa në tokë gjendet/ në thjeshtësinë e komunikimit/ në çiltërsinë e kristaltë/ në ndershmërinë e madhe dhe, si një thirrje për t’u mbajtur mend: “Njerëz, mos e kërkonj Parajsën në qiell, se atë e kemi brenda shpirtit!”

Para se t’i mbyll këto shënime të mia (autorja të më falë që nuk u ndala dhe në shkrime të saj), por nuk mund të rri pa lakuar atë shkrim me vlerë e plot dhimbje për babanë e saj. Edhe unë nuk e mbajta dot dhimbjen (ne, pleqtë, qajmë kollaj), por si për t’u gjendur moralisht pranë dhimbjes së saj, i them: Sa të drejtë kishte BORGES, kur shkroi: „Kur vdes një njeri, varroset një bibliotekë“. Kjo thënie sikur është thënë, enkas për babën tuaj që ti e quan „Enciklopedi e gjallë“: Një nxënës i SOKRATIT, ANTISTENI, ka thënë: „E vetmja gjë që nuk na i rrëmben askush, është kënaqësia që ndjejmë, kur bëjmë një vepër të mirë“. Ti ia ke arritur dhe unë të uroj: „Me „imagjinata“ të tjera!

**Përparim HYSI**  
**Tiranë, 9 tetor 2019**

## REFLEKSION

Duke i hedhur një vështrim të përgjithshëm librit të autores Vlora Banushaj Krasniqi me titullin aq domethënës „Imagjinata VS”, ndjen një krenari të vetëdijshme kur i lexon tregimet të formëzuara në ese. Ato marrin me vete atë pjalm e polen gjallërie përgjatë lexueshmërisë sonë si lexues, saqë të rrëmbejnë pas tyre për t’i lexuar gjer në fund. Në tregimet e shkruara prej autores Vlora Banushaj Krasniqi, do gjesh atë frymëzim që na jep jetë e dashuri njerëzore në pafundësi. Në stilin e saj të shkruar, Vlora, dallohet për një arritje cilësore letrare me mënyrën e stilin kur ajo merr penën për të derdhur mendimet në letër. Kjo e bën autoren që t’u shkojë hap pas hapi rrugëtimit krijues, si një gërshet të thurur me fjalën magjike plot tharmë poetik, fjalëve të shprehura në formën e prozës. Në gjithë tregimet e paraqitura tek ky vëllim i dytë prej saj, na rrëfen atë dialog letrar me shumë fines e plot ngjyra letrare. Kur lexon këtë vëllim, jo vetëm të tregimeve, të cilat i ngjajë pemës së lulëzuar pranverore, të ngrohin shpirtin njerëzor dhe të fusin në labirintet e kthjellta të imagjinatës së detit e të oqeanit krijues. Si rrjedhojë e kësaj imagjinatë me plot iluzione shprehëse optimiste; na duket sikur fluturojmë drejt hapësirës blu të qielli që nuk ndalet kurrë. Pikërisht, kjo ka ndikuar që edhe vetë

titulli i librit të marri trajta e forma interesante, i cili e mban të mbërthyer lexuesin tonë që t'i shkojë deri në fund lexueshmërisë së librit me titullin „Imagjinata VS”. Si një fjongo gërsheti të një vajze, përshkruhen edhe titujt e tjerë nga këta autorë tek ky libër. Në themelin letrar artistik të këtij vëllimi, qëndron DASHURIA NJERËZORE! Lajtmotivi i Imagjinatës shkon deri aty ku na thotë qartazi se: „Imagjinata të çon deri aty në kufirin më të bukur që ne e quajmë kopshtin e LUMTURISË!”. Dhe kjo është mëse e vërtetë. Ajo mposht çdo dhimbje, e si rrjedhojë të lartëson drejt qiellit të kaltër për të kapur yjet e dritën e tyre, pra DRITËN E JETËS! Po tu hedhim një vështrim të përgjithshëm brumit letrar tek ky libër, do gjejmë pa frik atë tharm letrar të shkruar bukur artistikisht, si rrjedhojë do gjesh tharmin e jetës. Këto i gjen me krenari që shprehin mall e gëzime, dhimbje e optimizëm, dashuri njerëzore, ku loti bëhet si një „meteor” i florinjte e rrezaton si dielli duke shëruar plagdhimbjet njerëzore.

Pra, shkrimtarja është vetvetja, prandaj ajo shkruan në vetën e parë, me një imazh domethënës: DASHURINË për JETËN! Në gjithë lëmin krijues të paraqitur në këtë vëllim të ri „Imagjinata VS”, duket si drita e diellit, si varka lundruese që përshkon „detin e oqeanin” me lirikën e stilin e të shkruarit që lexuesi do i gjejë pa vështirësi në këtë libër. U ndala për të bërë këtë parantezë, sepse dua që lexuesin të mos e lodh

shumë, por ai të kapi valët magjike të lumit letrar që na përcjell ky libër. Në brendësi, përveç tregimeve të formatuara në ese, janë shkruar edhe thënie filozofike, ku mesazhet që na përcillen ne si lexues, janë të fuqishme, plot kolor me filozofinë e tyre frymëzuese për jetën tonë të përditshme. Por edhe poezitë të një forme pentagramesh, të japin atë ndjesi të brendshme, ku reflektohet hapur ai zjarr i pafund i dashurisë njerëzore.

Ne po japim disa sekuenca rreth këtyre lëndëve shkrimore të refleksionit letrar analitik, sepse autorja ka ditur të na sjellin atë tharm letrar të spikatur te libri „IMAGJINATA VS”. Mesazhet janë të dukshme, ato shkruar si rrufetë qiellore e bëjnë dritë në shpirtin tonë njerëzor. Këto i gjejmë tek tregimet „NË PRAG TË VITIT TË RI, U ULA DHE SHKROVA...”, „NË MBRETËRINË E TRËNDAFILAVE”, „UDHËTIM NË VIJË KOHORE...”, „KOPSHTI I MIQËSISË SË ARTË”, „PARA PASQYRËS SË JETËS”, etj. E gjithë gama e shkrimeve ka një frymëmarrje, ku spikatet me gjithë ngjyrat e jetës brumi letrar. Si rrjedhojë, mendimet e imagjinatës arrijnë të prekin çdo skutë të qelizës sonë njerëzore, sepse me një mjeshtëri të kulluar artistike është gdhendur fjala e mendimi imagjinar, i afrohet të së vërtetës e botës shpirtërore njerëzore. Këtu, marrin udhë të gjitha iluzionet tona me qëllimin e vetëm: Në lëmin e Dashurisë për tek kopshti i trëndafilave të JETËS! Po japim disa fragmente të

shkurtra të shkëputura nga disa tregimet prej këtij libri, si më poshtë vijon: nga tregimi "Në prag të Viti të Ri, u ula e shkrova", „*Por, ky muaj ma solli në dorë një ëndërr që e kisha kur isha në moshën e artë të fëmijërisë. Dhurata me e veçantë nga një qenie e veçantë m'u dhurua. Jeta ime atë ditë e kishte emrin Lumturi. „Imagjinata V” është përmbledhur e përgatitur e tëra. Kështu quhej ëndrra ime e jetësuar! Dhe tash erdha këtu pra në muajin dhjetor... dhe çfarë mund të them për këtë Vit?!”*”, apo tek tregimi „Në mbretërinë e trëndafilave”, „...Dhe për çudi, në mesin e këtyre ngjyrave hyjnore, e ndjej vetën si mbretëreshë në një mbretëri trëndafilash, - e herë si engjëll që endem nëpër petalet e këtyre trëndafilave. Dhe sa herë që e ndjej vetën si një engjëll, unë thur dëshira për një shkëlqim. Por, edhe kur e ndjej vetën si mbretëreshë nën mbretërinë e trëndafilave, unë shpërndaj aromë për një shkëlqim.” Dhe vazhdon tek tregimi „Udhëtim në vijë kohore”: „Kështu, që rrugëtimi vazhdon në rrugën e tij të shtruar në dje-sot-nesër, e jo nesër, e pastaj në sot, ngase e SOTMJA i jep jetë të NESËRMES. Çfarë ngjyra do të hidhen sot, edhe piktura do të jetë e tillë!”. Një fragment i shkëputur nga tregimi „Kopshti i miqësisë së artë”, „Dhe sa herë që dalim nga aty, për t'u ritakuar në ditën tjetër, me vete marrim shkëlqimin që na jep ylberi i harkuar në qiellin vezullues, si kurorë e një miqësie të vërtetë njerëzore”. Lajmotivi i tregimeve (ese) janë si një buzëqeshje

zemrash, ku në themelin kanë Jetën, e në boshtin e tyre filozofik qëndron fort ai mendim si një gonxhe trëndafili, ku petalet zbresin ashtu ngadalë për tek ZEMRA TONA NJERËZORE! Kurse te tregimi "Para pasqyrë së jetës" na jep këtë fragment të bukur sa artistikisht aq edhe filozofik: „*Duke menduar kështu, e dëgjova një zhurmë! U drejtova në drejtim të asaj që e dëgjova më tej. Ishin "ca pika shiu"... e pas kësaj rrezet e arta të diellit takohen me shikimin tim, dhe më duket se e mora një përkrahje të fuqishme në këtë rrugë të gjatë që jam nisur...*

*E unë vazhdoj të mendoj me zë para pasqyrës së jetës sime, sa herë takohem me vetën...?!*

*Unë vazhdoj ta lexoj jetën...! Vazhdoj t'i dëgjoj tingujt e jetës, dhe sigurisht t'i buzëqeshë asaj që e ka emrin JETË!"*

Sigurisht, Vlora Banushaj Krasniqi kërkon nga vetja e nga të tjerët, që në zemrat tona përgjatë rrugëtimit të jetës, të lundrojnë gëzimet me qëllimin e vetëm: aty në zemrat e njerëzve të buzëqeshin në kopshtin e artë përherë GONXHET E JETËS! Ajo e përmbyll aq bukur këtë mesazh, sa që vetja të duket sikur rrugëton me të vërtetë nëpër kopshtin e trëndafilave. „*Në vesh një trëndafili i thash: A e din se çfarë ka të re? Unë prapë jam zgjuar, unë prapë do ta hedhë një emocion në fletët tuaja. E, Ai trëndafil lehtas më buzëqeshi, e më tha: U gëzova shumë! Shkruaj, të lutem, se kështu dua të të shohë, përherë të zgjuar, duke*

*shkruar vazhdimisht...! „E kur arrita këtu ku jam, ZEMRA po më thotë të shkruaj kështu: „SA MË SHUMË RRUGË TRËNDAFILASH PAQI NË JETËN TUAJ, TË GJITHË JU O NJERËZ TË MIRË”.*

Është befasuese, por edhe e kuptueshme, sepse autorja e këtij libri, ka gjetur atë rrugë të gjatë, por me buzëqeshje JETE! Gjithë lumturinë e saj ia ka lënë kohës së pafundme... e si rrjedhojë e kësaj gjen atë KOHË të ARTË, e ulet e krijon edhe me Sabir Krasniqin (ku bashkudhëtojnë së bashku si një e të pandarë), duke shkruar fjalët e bukura shqipe në letër. Këtu merr një kah tjetër me të vërtetë jeta e PAVDEKËSISË së tyre. E themi këtë, jo për parantezë, por është më se e vërtetë: Dy mendje e dy zemra hedhin të shkruara në letër mendimet e tyre. Kjo është sa magjike, ashtu edhe HYJNORE, sepse fjala e shkruar mbetet në shekuj, ajo të PËRJETËSON! Me thëniet e arta të formuluar prej tyre, është një domethënie e madhe, ka peshën e maleve e të deteve. Të bashkosh dy mendime në një të vetëm, sikur janë mendimet e dy autorëve të këtij libri „Imagjinata VS”, është sikur të bashkohet qielli me tokën. Por ja, kjo ka ndodhur me të vërtetë. Lexuesi do e gjejë fare të lehtë tek „Thëniet e arta për jetën” në brendësinë e librit. Po e ilustruam konkretisht me disa shprehje me përmbajtje filozofike e letrare të formuluar prej tyre... Dhe shkruajnë... ”*Një petal buzëqeshjeje me gjithë zemër, derdhi plot nektar, nga i cili u ushqyen e po ushqehen, pandërprerë qeniet*

tona, dhe të gjitha këto petale formuan lulen e **MIQËSISË TONË TË ARTË!**”.

-Dhe vazhdon...

*„Sa herë hapet një petal i Miqësisë  
Shpirtërisht yjet në engjëj i kthen,  
Parajsën gjithmonë në tokë e sjell,  
Magjinë hyjnore në dëshirë ta ndjell.*

*Sa herë hapet një petal i Miqësisë  
Aroma e saj si nektar jete, shpirtra ushqen,  
Bashkë me ngjyrat me të bukura të jetës  
Shkëndijat e shuara në shkëlqim të artë i  
rikthen.”*

-Dhe e mbyllin me këtë paragraf letrar filozofik:

*„Miqësia është më shumë se një fjalë e thjeshtë.  
Mund të tentojmë ta përshkruajmë, por, vetëm një  
komunikim maratonik me letra që transmetojnë  
mendime, ide, porosi brilante dhe të arta që jetojnë  
nëpër kohë, i japin kuptimin e drejtë dhe të mirëfilltë.  
Lum kush e përjeton këtë **MIQËSI HYJNORE!**”.*

Pa buzëqeshje s’ka jetë. Pikërisht, ajo është burimi i të gjithave, i mirësisë kur, i buzëqesh nga zemra, me pastërtinë Hyjnore të **PERËNDISË!** Vlora Banushaj Krasniqi, e shpreh fuqishëm këtë në gjithë pentagramet letrare me përmbajtje filozofike.



„Mbështetu në BUZËQESHJE! „*Një nevojë e imja, por, jo vetëm e imja, besoj e secilës qenie njerëzore në këtë univers, Buzëqeshja!*”. Të urresh, thotë autorja është gjëja më e shëmtuar e kësaj bote. Urrejtja është manifestim i brendshëm që e kultivojnë vetëm ata njerëz, të cilët kanë një botë shumë të vogël në shpirtin e tyre. Pra, të urresh, është dështimi më i keq i qenieve njerëzore. Prandaj autorja bën një reflektim të qartë e thirrje nga zemra e saj, që të mbjellim dashuri sa të jemi në këtë botë! Kjo reflektohet edhe në tregimin „Mesazh festiv” ku, me bashkautorin S. Krasniqi, shprehen kështu „*Të kultivojmë vetëm farën e dashurisë - frymën hyjnore, në të gjithë hapësirën e këtij Kopshti të parajsorë, që frutat e saj t'i ndjejmë, t'i shijojmë, t'i përjetojmë, ...Urojmë që kjo perlë e lumturisë ta stolisë zemrën e secilit nga ju - zemrat e gjithë njerëzimit! GËZUAR!*”. Tek poezia „Miqësia e artë”, bashkautorët na sjellin një tjetër tablo, ku mendimi e fjala e formësuar në fjali poetike, jep atë mesazh drite që na ngroh zemrat ne si qenie njerëzore. „*Miqësia e Artë zbret nga lartësitë më të pastra hyjnore, prandaj i ngre gjithnjë lart në pedestal ata që e mbartin. Prej këtyre njerëzve bota zbukurohet e ndodhin mrekullitë!*” apo, „*Mik i vërtet është dikush që e njeh melodinë e zemrës tënde dhe e këndon atë kur ti ta kesh harruar!..., dikush që të dhuron nektar jete... sa herë që je i mërziur, dikush që të plotëson, atëherë kur ti harron diçka, dikush që të kupton edhe kur heshtë!*”. Dhe në mbyllje

tek këto fragmente letrare, por që mbartin zërin letrar filozofik na shprehen kështu: „*Rrezet e Miqësisë së Artë e shndrisin qiellin e shpirtit edhe atëherë kur aty mbretëron errësira e plotë!*”. ...dhe finalizojnë me shprehjen LAPIDARE: ”*Le të jetë miqësia jonë një fanar drite në det, kur ne të ndihemi të humbur në anijen me emrin JETË!*”.

Një tjetër dukuri që lexuesi do gjejë në këtë libër, është se do gjejë edhe formën tjetër të një stili letrar të shkruar. Kjo ja rrit edhe më shumë vlerat librit. Të bën kurajoz, sepse forma e dhënë ndërtimore, prek pak poezinë e traditës, por në fakt nuk është poezi e mirëfilltë. Kjo rrymë e stilit të shkruarit, në veprimin e të menduarit e mesazhin që përcjellin, është e formës pentagrame të shkurtra të formatit poezi. Kjo e bën që të ketë atë dallim esencial letrar. Por, që tenton t’i afrohet poezisë së mirëfilltë letrare. Ne, p.sh. po sjellim disa nga këto vargëzime poetike, të cilat të rrëmbejnë në lëmin e tyre të grunjtë, vala e dashurisë ndihet kudo deri në univers. Dhe këto lexuesi i gjen tek poezia me titullin „Çast”, si:

*„Kërko dikë që di të të bëjë të buzëqeshësh,  
Gjej atë që e bën të qeshë zemrën tënde...  
Pasi njeriu më i bukur është ai që sjellë  
buzëqeshje kudo që vjen!  
Mjafton vetëm një buzëqeshje e tij,*

*për ta kthjelluar qiellin e universit tënd nga  
gfarëdo lloj vranësire...*

*„Jeta është vijë,  
ngjyrën e te cilës e shohim sot,  
ndërsa ngjyrat që dëshirojmë t'i shohim  
i pikturojmë në galerinë e shpirtit...*

*„Lumturia është pranë secilit prej nesh,  
Mjafton vetëm të hapim zemrën,  
dhe ta lejojmë diellin e jetës të shkëlqejë mbi  
ne!...*

*„Njerëzve që kanë ditur dhe arritur,  
bashkë me ty,  
të ndërtojnë Kopshtin parajsorë:  
**BUKURINË E PËRKRYER TË JETËS!**”.*

Vetë JETA jonë është KËNGË! Ajo duhet të këndohet në çdo ditë, sekondë, muaj e vite... Po, po, ajo është burim që s'shteron kurrë e mbjell fidan lumturie në zemrat tona. Kënga e zbukuron shpirtin tonë, shëron plagët, zbut dhimbjet, me tinguj e saj na jep ngrohtësi në çdo qelizë të trupit tonë. E ku ka më bukur se kënga! Autorja e këtij libri Vlora Banushaj Krasniqi na vjen me një arsytim tjetër, në stil, formë ndërtimore të lëndës letrare, në mesazhe, por edhe në paraqitjen e botës së brendshme, ku figurat letrare lëvizin me

shpejtësi në gjithë dinamikën e lëndës së këtij libri. Kjo ja ka rritur edhe më shumë vlerat librit.

Simbolikat e përdorura tek tregimi „Monolog” janë kuptimplote; ajo bisedon me vetveten, dhimbja për babain i ka lënë atë plagdhimbje, por edhe dashurinë e madhe që e ruan në folenë e zemrës së saj. Çdo ditë e gjen duke bashkëbiseduar me të atin, në rrugëtimin e vazhdimësisë së jetës, ai i gjendet pranë, në gëzime apo hidhërime. Loti i ngrirë në sytë e saj, ndrit si yjet që zbresin nga malet që vështrojnë qytetin e lindjes Pejë, si rrjedhojë i bëjnë dritë në shpirt dhe i japin buzëqeshje. Lot drite, fjalë e shkruar për babain tek ky monolog, është i larë me ujë floriri. E ku ka më bukur të shkruash për prindërit, e sidomos për BABAIN!? Ja si shprehet Vlora Banushaj Krasniqi tek ky fragment që po sjellim për ilustrim, çka ne kemi thënë si më lartë përmendur:

*„...Dhe sa herë që më jehonin këto fjalë inkurajuese në vesh, unë buzëqeshja në heshtje. Doja t'ia plotësoja dëshirën, sepse ashtu ishte dëshira e asaj mendje që unë të buzëqeshë sa më shumë, por, edhe unë sa shumë kam dëshirë që t'ia rikthej këtë nektar jetel!....*

*Të shikoja çdo ditë se si të shuhej jeta dalëngadalë në sytë e tu. E fsheha lotin nga Ti babë. E mbulova dhembjen. I palosa kujtimet për t'i ruajtur me kujdesin ma të madh. Ti ike nga ne me buzëqeshjen,*

## IMAGJINATA VS


---

*dashurinë, ngrohtësinë, bujarinë, universin e pafund...!*”.

Duke e mbyllur këtu këtë analizë letrare, iu urojmë autores Vlora Banushaj Krasniqi, suksese të mëtejshme në rrugën e bukur të krijimtarisë. Libri „Imagjinata VS” le të ndriçojë semaforët e tij drejtë imagjinatave të JETËS e LUMTURISË NJERËZORE!

**Xhevahir CIRONGU**  
**Durrës, 22 tetor 2019**





## NË PRAG TË VITIT TË RI, U ULA DHE SHKROVA...

„Jeta e fshehtë magjinë dhe artin e vet.” Ishte kjo fjalja e fundit që e lexova në librin që po e mbaja në duar. Shkova pranë dritares ku zakonisht mbështetem kur e ndjej se duhet të pushoj pakëz, dhe ashtu e heshtur vështroj. Fjollat e kristalta të borës binin lehtas, ngadalë e pa u ndier. Ashtu heshtazi, dalëngadalë mbështjellin gjithçka me bardhësi. Edhe pse e ftohtë, e akullt, qysh në shikim të parë, ajo pamje të bën për vete! Çdo fjollë që bie, bashkë me të, më duket se thellohet e më mbështjell qetësia, paqja dhe prehja. Duke i marr këto ndjesi nga jashtë, e kthej vëmendjen brenda dhomës dhe dëgjoj kërcitjet e drunjve që ndizen dhe e ngrohin krejt ambientin. Kësaj atmosfere të ngrohtë dimërore i shtohet edhe vija e avullit të ngrohtë që gjarpëron duke lëshuar njëkohësisht valë arome mjaft të këndshme. Të gjitha këto janë shenja që tregojnë se stina e dimrit, jo që ka trokitur, por edhe ka arritur. Është muaji i fundit i vitit. Muaji dhjetor i vitit 2009.

Janar, shkurt, mars, prill, maj, qershor, korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor dhe tash jemi në muajin dhjetor. Kështu po i rinumëroja edhe një herë muajtë - muajt e këtij viti. Duke e ndjekur shprehinë time në



prag të çdo Viti të Ri, kur unë ulëm dhe i hapë shtigjet e mendjes, i shpupurisë copëzat e kohës, i kapë momentet më të gëzuara apo më të mërzitura që i kam kaluar gjatë këtyre muajve. Duke hedhur hapat e mi nëpër rrugët që i kam shkelur, mundohem të nxjerrë përgjigje për shumë pyetje që i kam përgatitur në këtë fundvit. Dhe sa herë që i kam llogaritur kështu, pra në fundvit, momentet e gëzuara dhe ato pak më të mërzitura (edhe kur në ndonjë muaj kanë peshuar më shumë momentet paksa me të zbehta), në një farë mënyre e kam arsyetuar edhe vetveten se, me siguri, ka pas edhe çaste shumë të mira. Por, duke qenë, si të thuash, pre e ndonjë shqetësimi, stresi, ndonjë çast edhe ka kaluar pa u vërejtur fare, dhe unë nuk kam bërë asgjë, apo nuk kam qenë e vetëdijshme se ai çast ishte në mes nesh, se ai erdhi, m'u ofrua, porse indiferenca ime e bëri që të ikën në përjetësi, dhe atë pa u hetuar.

E prapë tash, kur jam ulur m'u në prag të këtij viti, po i kërkoj ato çaste! Dua që vetëm ato të ma kenë mbushur këtë vit... Dhe pyetja e radhës është: A kishte më shumë rreze dielli, apo copëza akujsh?! Kishte më shumë vranësira, apo mjegull?! A piku ndonjë copëz ëndrrë, apo ra në dremitje më të thellë?! Isha zgjuar, apo fjetur?! Çfarë afirmimesh i kisha dhënë ndërrijes sime?! Ishte ngrirë loti në qerpikë, apo buzëqeshja kishte shndritur?! Mora diçka, çka nuk dhashë, apo dhashë diç dhe nuk mora asgjë? Sa stinë kishte ky vit? Apo gjithë viti ishte vetëm një stinë?!...

E pra, të fillojmë me hapin e parë e të rikthehemi për pak çaste prapa në kohë. Dhe para se të fillojë këtë udhëtim nëpër shkallët e kohës marr frymë thellë:

Çfarë mund të shkëpus nga muaji i parë i vitit, pra, nga Janari? Ah, po. Mund t'i veçoj disa rreshta! Pikërisht këto fjali që e përbënin një letër, ishin burimi i një miqësie hyjnore. U lidhë një urë që bashkonte pastërtinë me qetësinë, sinqeritetin me njerëzinë. Gjithçka do të ishte e pastër si një kristal dhe asgjë e mjegullt. Gjithçka shumë njerëzore dhe asgjë e mbështjellë me dyshime, rezerva...! Po hapeshin dy ditare të jetës... dhe vazhdojnë të shfletohen e lexohen.

Muaji shkurt 2009. Nuk festova e vetme. Të gjithë u bashkuam në vallëzim zemrash. Po e festonim një vjetorin e ëndrrës sonë shekullore që ishte bërë realitet. Në këtë muaj ishte urimi: Gëzuar!

Muaji Mars! Vendtakimi i dimrit me pranverën! Përsëndeten, duke ia lëshuar radhën njeri-tjetrit. Edhe mua më takoi me shumë pikëpyetje! Dhe kur koka më rëndohej nga këto pikëpyetje të mëdha, dilja në natyrë, në gjirin e saj doja ta merrja atë pushimin që ma jep ajo sepse unë e ndjej, e ndjej thellë në shpirt madhështinë e saj. Luhatesha para një udhëkryqi të jetës: Të nisem apo jo? Ishin pikërisht miqtë e mi që më shtyn të hyja në këtë shteg jete. U nisa... Hapin e parë e bëra... Hyra... Jeta është sprovë. Nuk është e thënë gjithherë të nisesh me buzëqeshje!

Muaji prill dhe maj më sollën shumë pritje, drithërima, buzëqeshje në rrugën që veçse isha nisur... Festova! Në muajin maj, po ashtu një javë e kisha të mbushur me gëzime, qeshje. Isha e shkrirë në dashuri, mall...

Muaji qershor dhe korrik po e kurorëzonte punën time që tashmë ju kisha përveshur me shumë zemër... Mora përgjigje! U gëzova! Po ashtu në muajin e kallinjve, isha afër aurës së një qenie të përndritur...!

Erdhi muaji Gusht për të cilin e kisha rezervuar pushimin tim psikik dhe fizik. Gjithë këto copëza të lodhjes që më kishin goditur i mora me vete dhe u ula buzë detit. I rrëfeva valëve të detit shumëçka të pathënë... I tregova edhe ngjyrat që e përshkojnë brendinë time. Ishim vetëm unë dhe deti! Askush nuk po e dëgjonte këtë dialog. I rrëfeva shumëçka. Ndërsa valët e tij si dhuratë ma falën qetësinë, frymëzimin, paqen..., i mora sepse kisha shumë nevojë për to.

Në muajin shtator u ktheva për ta nisë betejën e re, në rrugëtimin e ri aspak të lehtë. Po nisesha në këtë betejë të re me shpresën se duhet të dalë - të dalë e suksesshme.

Erdhi muaji Nëntor. Ky është muaji prej të cilit vazhdoj t'i numëroj e t'i festoj vjeshtat e mia.

Por, ky muaj ma sollti në dorë një ëndërr që e kisha kur isha në moshën e artë të fëmijërisë. Dhurata me e veçantë nga një qenie e veçantë m'u dhurua. Jeta ime atë ditë e kishte emrin Lumturi. „Imagjinata V”

ishite përmbledhur e përgatitur e tëra. Kështu quhej ëndrra ime e jetësuar.

Dhe tash erdha këtu, pra në muajin dhjetor. Dhe çfarë mund të them për këtë Vit?! Ah, po harrova t'ju them se rreshtat që u nisën në muajin janar, vazhduan rrugëtimin duke u përkundur me aromën e këndshme të pranverës, duke valëzuar me vallen e kallinjve, duke shkelur në gjethet e zverdhura të vjeshtës e deri këtu ku jam duke i shikuar kristalet e borës. Shumë e bukur kjo rrugë që të besohet se është e vërtetë! Por, jam dëshmitare unë... se gjithçka që ka burim pastërtinë, njerëzinë, ka jetë të gjatë, dhe kur këto dhurohen në mes qenieve njerëzve ato vetëm se shumëzohen.


Dhe çfarë të them krejt në fund të kësaj faqeje të jetës: Gjithë ditët e këtij viti i përshëndeta me afirmime pozitive: Dashuria e Zotit e mbush shpirtin tim!

Mund të them se jam e buzëqeshur përderisa i shkëputa këto që i përmenda.

Andaj, unë me këtë vit do të ndahem e buzëqeshur, dhe po ashtu me buzëqeshje do ta përqafojë edhe Vitin e Ri 2010!

Uroj dhe lutem që t'ju buzëqeshë zemra të gjithëve në vitin që po na troket.

*Klinë, 20.12.2009*



## NË MBRETËRINË E TRËNDAFILAVE!

Prapë u zgjova! U zgjova të jetoj, e të „lundroj” nëpër rreshta e të pushojë nëpër shumë vargje... të vallëzoj nëpër pentagramet e tingujve të artikuluar të jetës. Kam bredhur nëpër shumë mendime, ide, nëpër shumë pikëpyetje e pikëçuditje..., jam ndalur në një pikë të madhe, e pastaj jam strehuar tek buzëqeshja! E pastaj prapë kam vazhduar të lozë nëpër labirintin e imagjinatës sime. Aty kam bërë lloj-lloj kombinimi: kam bashkuar një copëz ëndrrë me një copëz realiteti, një copëz dëshirë me një copëz ngrohtësie, një copëz shprese me një copëz rreze. Të gjitha këto i kam bashkuar e gërshetuar me fijet me të ndjeshme të shpirtit tim. Të gjitha këto i kam shikuar, sa e sa herë, me sytë e mendjes sime e jam kënaqë - shumë jam kënaqë dhe kam folur në heshtje me krejt zemrën time! Kam dëgjuar në thellësi me gjithë shpirt..., dhe nëpër gjithë këtë pëlhurë të bukur jete më parakaloi duke u përsëritur në vazhdimësi, në një moment, një fjali vezulluese e ndriçuese: „Zgjohu! Rri e zgjuar!... Mos jeto e fjetur në madhështinë e jetës!“ Kjo fjali m’u dukë se kishte zbritur vertikalisht për t’u shtrirë në horizontalisht.

Duke e dëgjuar këtë jehonë me shpirt e, duke e ndërprerë këtë udhëtim timin me mendje, që po më ofronte një rehati, ndonjëherë deri në „kotësi”, u ndala

të shikojë pak edhe përtej kësaj kohe! Fillova të lëvizë edhe përtej kësaj hapësire! Hedha hapin edhe përtej këtej realiteti - përtej kësaj që po më prezantohej! Po cila ishte dëshira ime? Të pushojë apo të molisem? Të molisem duke qëndruar në një vend, në një pikë e në një re mendimi?! Pyetje ndoshta pa përgjigje, apo përgjigje që s'dua ta dëgjojë e ta pranojë? Ndoshta! Krejt kjo është ndoshta?! Pasiguri sjellë kjo fjalë „Ndoshta!” Apo mendimet e mia e sjellin këtë ndjesi brenda qenies sime?! M'u dukë se ajri po më mungonte..., m'u dukë se gjithçka përreth ishte mbytë e mbështjell në një ngatërresë! Heshtje që të fundosë në cektësi! E unë nxitova prapë! Shpejtova që ta hedhë shpejt e shpejt këtë mendim në harrim. Kisha frikë se, sa më shumë të koncentrohesh në këtë mendim, do t'i jepja jetë, do ta fuqizoja e pastaj ta jetësoja këtë mendim që nuk korrespondon me dëshirën time! JO dhe JO e madhe! E pas kësaj u nisa prapë të jetoja në TASH! E kuptova se nuk duhet ta kaloj të pranishmen - nga ajo se çfarë po ndodhë sot! E nesër?!... Kështu që rrugëtimi vazhdon në shtegun e tij të shtruar në dje-sot-nesër, e jo nesër, e pastaj në sot, ngase e SOTMJA i jep jetë të NESËRMËS. Çfarë ngjyra do të hidhen sot, edhe piktura do të jetë e tillë!

Dhe..., e zgjuar prapë vazhdova të ecë aty ku zemra dhe mendja ime SOT po bashkëjetojnë. Janë pajtuar në këtë rrugëtim. Të dyja po frymojnë njëkohësisht! Para syve të shpirtit tim u shtrua një

panoramë me një rrugë trëndafilash! Sytë e mi përsëri shkëlqyen, fytyra ime përsëri buzëqeshi. O sa shumë janë dhe: O Zot! - sa të bukur që janë! Këtu nuk ka numra, ka vetëm përmbajtje! Përmbajtje dhe thellësi! Gjithë këta ne i kemi mbjellë! Realitet i bukur, vështirë për t'u besuar...! Po për ta rrëfyer? Është diçka që vetëm përjetohet. S'ka vend për fjalë! Këtu ka qetësi dhe harmoni, bukuri dhe paqe. Në gjirin e secilës nga ato fshihet nga një copë jete e jetuar; në petalet e secilës nga ato është e mbështjell një copëz ëndrrë; në fletët e secilës është e strukur aty-këtu një copëz dëshirë; në gonxhet e tyre është strehuar ndonjë fjalë e pathënë... Rrënjët e tyre janë të ujitura me ujin me të pastër e të kristaltë. Trupi i tyre është i ushqyer me shumë dashuri. Brenda këtij qielli të kësaj mbretërie trëndafilash me ngjyrat hyjnore, unë flas, unë dëgjoj, unë ndjej, unë jetoj... Unë jam ajo që jam. Dëgjojë dhe flasë! Por, edhe këtu ka rend, ka harmoni. Një ditë unë e dëgjoj gjuhën hyjnore që flet një trëndafil, ditën tjetër unë i rrëfhem atij dhe kështu, dalëngadalë dhe krejt në mënyrë të heshtur, është krijuar një lidhshmëri e pashpjegueshme, e pasqaruar, një mishërim me këtë rrugë të gjatë - shumë të gjatë trëndafilash, me rrugën time të shpirtit.

Këtu çasti shënohet si një çast magjik! Kujdesem unë, por, kujdeset me shkëlqimin e tij edhe një SHKËLQIM BRILANT! A do të mund të rriteshin e të jenë kaq të bukura të gjitha këto pa dy shkëlqime?!



Sigurisht se JO, sepse këta e krijojnë një tërësi. Rrugë shumë e afërt, shumë e dashur, shumë e ngrohtë për mua, por e largët për të tjerët - e paarritshme, e pakapshme... deri në pakuptimësi, deri në absurditet! Gjithçka e pakapshme për dikë, duket e pakuptimtë. Por, do të doja që shumëkush ta prekë këtë „pakuptimësi“, ta ndjej, ta përjetojë...!

Dhe për çudi, në mesin e këtyre ngjyrave hyjnore, e ndjej vetën si mbretëreshë në një mbretëri trëndafilash, e herë si engjëll që endem nëpër petalet e këtyre trëndafilave. Dhe sa herë që e ndjej vetën si një engjëll, unë thur dëshira për një shkëlqim. Por, edhe kur e ndjej vetën si mbretëreshë në mbretërinë e trëndafilave, unë shpërndaj aromë për një shkëlqim. Dhe më ndodhë shumë shpesh të shëtis nga një trëndafil në tjetrin, shpesh i rikthehem t'i shikoj, t'i mikloj me sy, dhe nga secili marr nga një pikë ngjyrë hyjnore dhe me këto ngjyra dua ta bëjë pikturën time më të bukur deri tani dhe ta ruaj të ekspozuar në galerinë e shpirtit tim si piktura ime më e veçantë ndër të veçantat. Sa herë të „zgjohem“ e ta prek realitetin e egër, sa herë të jem e rrethuar nga tingujt e jetës plot zhurmë, që shpesh dinë të jenë më të ngatërruar se vet ngatërresa, atëherë do të nisem në këtë rrugë trëndafilash e të strehohem aty... e të marr pak diell, pak qiell, të ngjitem atje tek hëna në lartësi, netëve të gjata e pagjumë, e ta shikojë prapë atë Shkëlqim në Tokë që aq njerëzishëm frymon.


Dhe një ditë kur unë do të jem diku larg... shumë larg. Po, po, larg fjalës së shkruar, larg magjisë së artit, e mbërthyer brendapërbrenda rregullave të kufizuara, këtë pikturë që flet me tingujt e saj hyjnor, do t'ua lë ta shikojnë e lexojnë të tjerët që dinë ta lexojnë jetën pak me në thellësi, e ta ndjejnë se çfarë harmonie e përsosur ndjehet në këtë mbretëri trëndafilash.

Jam e zgjuar tashmë apo jam në një ëndërr të bukur të shndërruar në realitet?! Ku ta gjej një përgjigje të tillë, Ku? Ku tjetër, vetëm se në gjirin e këtyre trëndafilave apo?!

Në vesh një trëndafil i thash: A e din se çfarë ka të re? Unë prapë jam zgjuar, unë prapë do ta hedhë një emocion në fletët tuaja. E, AI trëndafil lehtas më buzëqeshi, e më tha: U gëzova shumë! Shkruaj, të lutem, se kështu dua të të shohë, përherë të zgjuar, duke shkruar vazhdimisht...!

E kur arrita këtu ku jam, ZEMRA po më thotë të shkruaj kështu:

**„SA MË SHUMË RRUGË TRËNDAFILASH PAQI  
NË JETËN TUAJ, TË GJITHË JU O NJERËZ TË  
MIRË“.**



## UDHËTIM NË VIJË KOHORE

Po ecja rrugëve të qytetit tim ende të përgjumura! Bashkë nëpër atë vijë të zgjimit po zgjoheshin edhe shpresa dhe dëshira, që kjo ditë të më përqafonte me një buqetë buzëqeshjesh; ngase unë veç ia kisha falur një buzëqeshje agimit të asaj. Ishin orët e hershme të një mëngjesi veror të muajit korrik, kur unë po kërkoja edhe nga dielli që ta ndezja shpirtin tim me rreze të arta të tij, qenien time ta mbushja me plot energji pozitive, ndërsa mendjes t'i jepja sa më shumë jetë, e vet jetës sime, që po hapëronte edhe në këtë ditë, sa më shumë ekzistencë!

Vazhdova të ecë duke i dëgjuar vetëm hapat e mi... dhe po i shikoja ndërtimet e shumta! Më dukej se nuk kishte mbetur as edhe një hapësirë pa u mbushur me mure dhe herë pas here, gjithë ato mure të ngritura, po i jepnin pushtet ngjyrës së hirtë e cila sikur po ma zinte frymën - më dukej shumë e pajetë, e pashpresë! Sytë e mi e kërkonin ngjyrën e blertë - atë të natyrës. Kisha nevojë për pak freski, për pak aromë natyre, për pak më shumë hapësirë, dhe për çudi më dukej krejt një qytet tjetër, qyteti im SOT! Po ky ishte qyteti im! Aty në çdo cep të tij, e më shumë, aty afër valëve të lumenjve, kishin mbetur ëndrrat e shumta fëmijërore që s'mundesha t'i numëroja sepse ishin porsu uji rrjedhës.

Por, ja që mua ai qyteti i fëmijërisë, i ekspozuar në galerinë e shpirtit, më dukej shumë ma i ngrohtë, me shumë ma shumë ngjyra të gëzuara, të hapura, të qeshura, shpesh edhe përrallore, ndoshta pse atë e kisha pikturuar me brushën e ngjyer në imagjinatën e fëmijërisë! Apo, ndoshta nga ajo se si ndihesha shpirtërisht në ato momente, po e shikoja edhe qytetin tim pak ma ndryshe!

Dhe kështu, duke i ribashkuar të kaluarën me të tashmen, arrita në stacion të trenit. U ndala. Por, mendja ime nuk ishte ndalur. Ajo po udhëtonte me krahët e saj për t'u rikthyer prapa në një ditë vjeshte të një muaji tetor, para shumë e shumë vitesh. Ishte ajo një ditë kur unë u nisa drejt një rrugë të re, të panjohur për mua dhe të zgjedhur po ashtu nga unë. Një rrugë aspak e lehtë që po shtrihej në një kohë të pakohë. Por, dëshira e madhe për ta çarë çdo lloj errësire të padijes po i jepte jetë kësaj rruge dhe... eh, ishte një kohë kur shtëpitë ishin shndërruar në shkolla, kur pasiguria ishte e pranishme në çdo cep... Për një çast, fishkëllima e trenit që u dëgjua nga një largësi që po vinte gjithherë duke u afruar, më ktheu prapë në këtë kohë. Seç e pata një ndjesi të veçantë në atë moment! E sidomos kur e ndjeja se po afrohej, e po ashtu edhe unë po i afrohesha. Dhe ato ndjenja të përziera, të cilat edhe i mora me vete, po vazhdonin të më shoqëronin gjatë gjithë atij udhëtimit. Sa më kishte marrë malli ta dëgjojë atë zhurmën që e lëshon treni gjatë përshkimit nëpër binar

me të njëjtin ritëm gjatë gjithë kohës, por, edhe unë po vazhdoja të udhëtoja prapë nëpër një vijë kohore, duke i prekur këto nëpërmes vijës shpirtërore. Shpesh, edhe nuk arrija t'i vëreja me sy disa nga stacionet ku ndalonte treni, vetëm shenja për nisje më kthente prapë aty ku isha edhe me trup. Edhe pse kishte mjaft bashkudhëtar, ca të zgjuar e ca gjysmë të përgjumur, nuk ndjeja nevojë për bisedë me dikë! Kisha shumë nevojë ta rigjej serish në vijë shpirtërore kontaktin me të kaluarën, me të djeshmen, sepse ajo ishte pikënisje për të ardhur deri tek ky mëngjes veror i muajit korrik. Por, edhe nuk ndihesha vetëm!

„Beso në dijen tënde, beso në fuqitë tua të brendshme dhe do të dalësh ngadhënjimtare - si përherë. Mua do të më kesh pranë – shpirtërisht, do të jem me mendje me TY (që në orët e para të mëngjesit)”. Një përkrahje e fortë shpirtërore nga një mendje dhe zemër që arrin të më kuptoj deri në atë masë si askush tjetër. Dhe sa herë që më jehonin këto fjalë inkurajuese në vesh, unë buzëqeshja në heshtje. Doja t'ia plotësoja dëshirën, sepse ashtu ishte dëshira e asaj mendje që unë të buzëqeshë sa më shumë, por, edhe unë sa shumë kam dëshirë që t'ia rikthej këtë nektar jete!

Sa pikë e largët më dukej se ishte stacioni ku unë do të ndalesha! Doja sa më parë t'i afrohesha stacionit të perëndimit, por edhe të shqetësimit, aty ku shumë pikëpyetjeve do t'i jepja përgjigje. Dhe mendja


s'po ndalej! Ajo nuk respektonte stacionet e ndaljes. Ajo ishte stacionuar në një vend dhe po vazhdonte të lundronte e të përplasej, herë pas here, nëpër valët e kohës... Dhe kur një dritë nga larg depërtoi në tunel, më kujtoi edhe atë kohë kur shumë pak dritë vërehej në fund të tunelit! E sot, para meje, po shtrihej një rrugë tjetër, një sfidë tjetër, por me shumë e shumë dritë. E pra, secila kohë po i barte shqetësimet e veta, ndërsa në anën tjetër po më provokonte natyra me bukurinë e saj dhe, siç dukej, edhe ajo po zgjohej dalëngadalë duke reflektuar çiltërsi, pastërti. Duke u njëjtësuar me këtë madhështi, në mendjen dhe shpirtin tim, herë pas here, ndizeshin fijet e shpresës për kapërcim sa më të suksesshëm edhe të kësaj sfide të radhës dhe i thosha vetës: a ka më bukur se shpirti të të mbushet me dritë? Sigurisht se nuk ka!

...Dhe kështu, duke e shfletuar librin e kujtesës, erdhi koha të shkëputem nga faqet e tij ngase, kur shikova nga dritarja, e kuptova se po hynim në qytetin pa lumë.

I përcolla hapat e të tjerëve, të cilët zbritnin për të ndaluar secili tek stacioni i tyre. Unë po vazhdoja e njëjtësuar me tingujt e shpirtit tim, herë pas herë, paksa të shqetësuar...







## KOPSHTI I MIQËSISË SË ARTË

Thuhet se: parajsa është vendi i ëndrrave, vendi i kënaqësive, vendi i lumturisë, vendi i paqes, vendi i mrekullive... por, diku lartë në qiell!

Po në tokë: -ku gjendet vallë parajsa?

Ajo gjendet në thjeshtësinë e komunikimit, në çiltërsinë e kristaltë, në pastërtinë dhe ndershmërinë morale, në ndjesitë më të larta të fisnikërisë dhe zemërgjerësisë, në butësinë dhe ngrohtësinë e zemrës, në shpirtat e ndritur të qenieve hyjnore!

Këto kualitete të arta e brilante, manifestojnë madhështinë e parajsës në tokë, respektivisht, në mendjen, shpirtin, zemrën dhe trupin e njeriut. Këto vlera, m'u sikurse ato puhizat pranverore me aromën dehëse që burim kanë nektarin e jetës, i afrojnë njerëzit, lidhin shoqëritë, mposhtin urrejtjen, venitin djallëzitetë, sfidojnë stinët, sfidojnë vitet, krijojnë harkore ylberesh me ngjyrat më të gëzuara të jetës, ndërtojnë urat e një miqësie të vërtet njerëzore, dhe m'u këtu fillon të merr formë, fillon të frymoj, të merr jetë, të kultivohet me fisnikërinë më të lartë edhe një kopsht, që do ta quajmë, ashtu edhe siç e ndjejmë, „Kopshti i miqësisë së artë“ - ose parajsa e vërtet.

Sigurisht se secili kopsht e ka një burim, e ka një rrjedh..., e ka edhe një histori - faqe të ndryshme të saj, por me të njëjtin titull: „Kopshti i miqësisë së artë!“

Mund të jenë disa shkronja, një fjali, një letër..., fillimi i kësaj historie: shkronjave që mëkojnë me aq butësi filizat e parë, fjalive që ushqejnë me aq dashamirësi gonxhet e sapoçelura, letrave që formojnë me dashurinë më të sinqertë buqeta lulësh... nga mendje të ndritura, nga shpirta të pastër, nga zemra të bardha. Kështu ndërtohen kornizat e shtresuara me ar e shkëlqim brilanti të një kopshti, të vogël në dukje, por të madhërisëm në përmbajtje.

Çdo gjë që është e madhërishme, natyrisht, që të mahnit me bukurinë e saj. Dhe të gjitha këto mrekulli hyjnore i përqafojnë në këtë kopsht të miqësisë së artë. Sa herë që ndalon aty për ta soditur apo pushuar: gjen paqen dhe qetësinë shpirtërore, disponimin më të këndshëm, nektarin e jetës, harmonizimin e përsosur të ritmit hyjnor. Dhe nën tingujt e përsosur të këtij ritmi hyjnor, lehtë dëgjohet duke rrjedhë një ujëvarë buzëqeshjesh m'u në mes të kopshtit nga ku reflektojnë ngjyrat më të gëzuara të jetës. Dhe nën pushtetin e magjishëm të kësaj mrekullie, të quajtur lumturi, drejton shikimin kah burimi dhe i pëshpërit dy fjalë: „Përhëndetje Madhështi!“ Me anë të kësaj përhëndetje hyjnore i bartë të gjitha këto ngjyra të gëzuara jete, sikurse ylberi, deri tek syri, zemra dhe shpirti i miqve tu, bashkë me tingujt e gëzuar e skofiar

që rrjedhin ëmbël nga ujëvara e buzëqeshjeve, për t'ua falur edhe atyre këtë ndjesi të këndshme, këtë aromë dehëse, aromën e nektarit të jetës.

Aroma dehëse që shpërndahet nga kurorat e luleve përplot ngjyra magjepse, por edhe nektari i jetës që rrjedh nga ujëvara e buzëqeshjeve, të tërheq përherë e më shumë. Dhe nuk mund të kalojmë as edhe një ditë pa e vizituar këtë kopsht të miqësisë së artë, pa ndaluar aty, pa e soditur atë mrekulli të rrallë, pa e freskuar shpirtin tek ujëvara e buzëqeshjeve dhe pa mbjell në të, bile një filiz të ri. E kështu për çdo ditë, këtij kopshti i shtohet bukuria e madhështia, e bashkë me to mishërohet e forcohet edhe miqësia.

...Dhe stinët vazhdojnë të ndërrohen! Kalojnë muajt në kalendar por, në këtë kopsht, nuk bie ndonjë copëz akulli e as gjethet nuk zverdhën. Në vazhdimësi mbillen filiza të rinj, pavarësisht stinëve. Frytet magjepse që lulëzojnë, nuk arrin dot t'i dëmtoj as acari i egër i janarit, e as fuqia përvëluese e diellit në korrik, sepse rrënjët e tyre ujiten e rriten nga uji i bekuar i ujëvarës së buzëqeshjeve, nga freskia magjike që e lumturon shpirtin sa herë që e thithim atë aromë dehëse, nga ngjyrat më të ngrohta që gërshetohen e vezullojnë në harkoren e ylberit, në urën me rrezatuese nëpër të cilën shëtitën dhe hedhin hapat vetëm shpirtra të pastër engjëllor që kanë uratën e Perëndisë.

Pothuajse çdo ditë kemi nevojë të takohemi me vetveten..., dhe sa herë e ndjejmë këtë, nisemi drejt

këtij kopshti hyjnor për ta takuar harmoninë e përsosur: atë të shpirtit me trupin, të njeriut me natyrën, tokësore me qielloren. Dhe..., strehohemi e ulemi të pushojmë nën freskinë e ujëvarës së buzëqeshjeve duke u tretur edhe vet nën lojën gurgulluese të valëve të saj të gëzuara. Sa herë i hapë petalet (e saj) një lule, nga brendia e saj shpërthejnë e shpërndahen në qiellin e pastër të këtij kopshti grumbuj shkëndijash të mirësisë, pastërtisë, zemërgjerësisë, fisnikërisë..., të gjitha këto duke u lëkundur lehtë nëpër freskinë e mbrëmjeve plotë yje, për ta shkrirë e shpërndarë çdo lloj errësire në shpirt.

Dhe sa herë që dalim nga aty, për t'u ritakuar në ditën tjetër, me vete marrim shkëlqimin që na jep ylberi i harkuar në qiellin vezullues si kurorë e një miqësie të vërtetë njerëzore.

Miq të dashur! -parajsën (greqisht - kopshtin) mos e kërkoni në lartësitë e paarritshme qiellore, atë e keni përherë pranë, në brendi tuajën! Mjafton t'i hapni portat e zemrës dhe të shpirtit që ajo të manifestohet edhe përmes disa shkronjave, rreshtave..., për t'u transformuar në një kopsht hyjnor, për t'u shtresuar thellë, thellë në kujtesën e kohës, në përjetësi!

Të gjitha këto që i lexuat më lartë, me gjuhën e miqësisë ua thamë, dhe ju lutemi këtë mbajeni në mend: në shpirtin tuaj, një miku a mikeshë, bëjuani një vend. Një mik/eshë i/e mirë do t'ju vjen si një shkëndije shprese në jetë, burim energjie atëherë kur do të

ndiheni të lodhur, shkëndije lumturie kur do të prekeni nga trishtimi, burim force kur të ndiheni të dobët, strehimore në çaste ligështie.

*Vlora BANUSHAJ & Sabir KRASNIQI*



## PARA PASQYRËS SË JETËS

Pas një dite të gjatë, ndoshta edhe pak të lodhshme, u ula të pushojë pakëz. Sot komunikova me pranverën me gjuhën e ngjyrave! Kjo gjuhë e komunikimit me gjithë ato ngjyra të gëzuara, të hapura dhe me plot gjallëri më dhuroi një buqetë buzëqeshjesh dhe shkëndija lumturie. Buzëqeshte natyra! - buzëqeshja edhe unë! Më dukej se gjithçka ishte mbështjellë në buzëqeshje, duke i mbuluar ca re të vockla mërzie që rastisin të shëtisin në qiellin e shpirtit, ndonjëherë edhe në këtë stinë të ringjalljes së natyrës. Dhe, diku në rrugën e kësaj hapësire, të këtij komunikimi; e kapa, e ndjeva një thirrje, e mora një ftesë! Mirëpo, pas kësaj ftese, shkova t'i prek pak e t'i shijoj edhe ngjyrat e ëndrrave, aty ku harmonizohen e shkrihen ngjyrat e dëshirave që na i „dhuron realiteti” që shpeshherë, disa nga këto, thuhet shprehimisht e disa nga ato ndoshta mbesin përjetësisht të rezervuara thellë.

Për një çast hedha hapin dhe tejkalova pak realitetin, për të qëndruar vetëm për disa momente... e, pastaj u ktheva prapë për ta prekur realitetin. Ah, po, m'u kujtua ftesa që e kisha marrë sot. Një ftesë jo e zakonitë në dukje të parë! Por, nuk është hera e parë që e marr një ftesë të tillë! Nuk është hera e parë që jam e



ftuar. Nuk më është e adresuar nga ndonjë mik apo mikeshë! Jo. Nuk është e shkruar në letër, as nuk është e thënë me fjalë! Nuk vije nga jashtësia! Kjo është një thirrje pa zë, pa fjalë, pa zhurmë. Një ftesë e pashkruar! Por, ka tinguj, notat e të cilëve arrin t'i kapë vetëm veshi im! Thirrjen dhe dridhjen e ndjen vetëm zemra ime! Vendimin e merr mendja ime! Dhe ju përgjigja thirrjes. Ngase nuk kisha dyshime të shkoja apo të mos shkoja. Nxitova! Thuajse i kisha të numëruara minutat. Më thërriste shpirti, zemra njëzëri. Kisha shumë nevojë për këtë takim. Kisha nevojë pak të veçohem, së bashku me shpirtin tim, e të shtrihem në hapësirën time. Ta ndjej e ta shijoj këtë liri të pakufizuar, por me shumë përgjegjësi për mua! Andaj, erdha të takohem! Më kë?! -do të ishte pyetja e radhës. Po më kënd tjetër: Vetëm se me veten!

Takimi me vetveten! I mora të gjitha ato që më takojnë vetëm mua. Çdo gjë e huaj është e rëndë, e tepërt, andaj, edhe nuk e marr me vete, sepse nuk është pjesë e imja dhe nuk më shkon! Nuk flenë në natyrën time...! Jo, nuk dua zhurmë dhe atë zhurmë për asgjë!

Këtu ku shkoj nuk ka vend ajo që nuk më takon mua. Këtu gjithçka është pjesë e imja. Gjithçka... dhe Asgjë... Tash m'u kujtua kjo, sepse është e rezervuar për mua dhe unë e kam të rezervuar për dikë...! Gjithçka e mban vulën time. Gjithçka e mban nënshkrimin tim. Dhe sa herë që ngjitem në shkallët e

kësaj hapësire, në secilin moment ndihem më e plotësuar, më e përmbushur.

Sapo hedha hapin këtu, në hapësirën e rezervuar vetëm për mua, u ula dhe qëndrova para pasqyrës! Po, po, pikërisht para pasqyrës së jetës sime! Aty ku reflekton dhe pasqyrohet shpirti im, si është më së miri. Sipër pasqyrës harkohet ylberi i ndjesive të mia me të gjitha ngjyrat. Sigurisht se, para pasqyrës qëndron libri. Titulli i tij është: Libri i jetës! E lë aty afër, sepse secilën ditë e shpalos nga një faqe të re, dhe shpesh i rikthehem prapa ta rilexojë ndonjë fragment të jetuar, të kaluar aty; sepse aty në çdo faqe, në çdo rresht, ka mbet një pjesë e imja - gjurmët e hapave të hedhur. Për atë edhe kam shumë kujdes, se me çfarë po i mbushë këto faqe të librit të jetës sime. Faqet që i lë pas, janë vazhdimësi e faqeve që shkruhen, e këto pastaj do të jenë pikë referuese e atyre faqeve që do të pasojnë. E tëra rrjedhë dhe funksionon si zinxhir, e kaluara, e tashmja dhe e nesërmja. Nuk dua që një ditë, kur t'i rikthehem e ta shfletoj këtë libër, ta kem ndjenjën se duhet ta gris ndonjë faqe apo ta shlyej ndonjë rresht. Jo, të paktën ato që i kam unë në dorë, joooo...!

Dhe vazhdoj t'i shfletoj dhe të marr ndjesi nga me të ndryshmet: herë ndjej lumturi, e herë krenari, herë nostalgji, e herë-herë mall, herë gëzim. Ndonjë faqe ka edhe gjurmë loti... Ndonjë faqe, sapo ta hapë dalin shkëndijat e shumta të buzëqeshjeve dhe unë

tretem në to e dua të mbetem aty... Dhe, m'u kujtua ajo thënia: „Buzëqeshja me zemër është nektar i jetës”.

Mirëpo, mund të them se këtu ka shumë qetësi. Shumë paqe. Paqe me veten, e pastaj kjo bartet edhe tek të tjerët!

Mundohem ta kuptoj veten, e ndonjëherë kur tjetri nuk arrin të më kuptojë, unë të paktën mundohem ta kuptoj atë. Këtu nuk lëviz asgjë, në fakt nuk dëgjohet të lëvizë diç, mirëpo nuk do të thotë se nuk ka jetë – ka, dhe atë shumë! Thellësi dhe pafundësi... por, edhe unë kam shumë kujdes që ta ruaj këtë qetësi në këtë përditshmëri të zhurmshme.

Dhe nuk më tremb aspak ky takim! Nuk më pengon kjo qetësi, kjo heshtje, ky pushim, ky veçim. Jam më shumë se e mishëruar. Këtu e prekë atë ngjyrën që e dua pafundësisht: - kaltërsinë e qiellit, këtu e prek atë ngjyrën e artë të diellit, këtu e prek edhe ngjyrën e kuqërremtë të perëndimit të diellit, këtu e prekë edhe qiellin të ndriçuar me yje!

Gëzimi, shqetësimi, loti, buzëqeshja, malli, dashuria, të gjitha e kanë vulën me emrin tim. Këtu marr ajër lirshëm, këtu dëgjojë tingujt që s'arrij t'i dëgjoj në përditshmërinë time. Këtu ndodhë një transformim apo një pastrim i imi. Këtu nuk flas më askënd, por, nuk e ndjej nevojën të flas më dikë tjetër. Këtu marr shumë dashuri, shumë pastërti, shumë ngrohtësi..., shumë përgjigje nga pyetjet që i marr me vete!

Këtu, në tavolinën e jetës sime, i shtrojë para vetës gjithë ato që m'i ka ofruar jeta dhe çfarë kam bërë me to! Këtu i marr të gjitha përgjigjet! Mundohem ta zgjedhë atë më të mirën, atë më të arsyeshmen por, gjithherë duke mos e lënë anash atë shpirtëroren. Këtu funksionon harmonia, bashkëpunimi... ndjenjat janë shoqe me arsyen.

Duke folur me veten ndonjëherë mjegullohet shikimi dhe e ndjej se vazhdon të më ndjekë ajo ngjyra e hirtë... megjithëse edhe ajo është ngjyrë jete, apo jo? Askush nuk e sheh këtë ngjyrë, askush nuk e sheh këtë si ngjyrë që s'ka vend, por ja që unë nuk e pëlqej fare.

Duke menduar kështu, e dëgjova një zhurmë! U drejtova në drejtim të asaj që e dëgjoja më tej - ishin „ca pika shiu”... e pas kësaj rrezet e arta të diellit takohen me shikimin tim, dhe më duket se e mora një përkrahje të fuqishme në këtë rrugë të gjatë që jam nisur.

E unë vazhdoj të mendoj me zë, para pasqyrës së jetës sime, sa herë takohem me vetën...!

Unë vazhdoj ta lexoj jetën... Vazhdoj t'i dëgjoj tingujt e jetës..., dhe, sigurisht t'i buzëqeshë jetës.



## THËNIE TË ARTA PËR MIQËSINË

Një petal i artë shkëlqeu si brilant nga rrezet e ndritura HYJNORE,

Një petal njohjeje, u krijua nga një letër rastësisht,

Një petal shoqërie, u krijua nga letërkëmbimi ynë në vazhdimësi,

Një petal besimi, u krijua nga sinqeriteti deri në imtësi,

Një petal fisnikërie u krijua nga pastërtia e kristaltë,

Një petal ngrohtësie rrodhi nga burimi i thellë shpirtëror,

Një petal nuancash mahnitëse shkëlqeu nga ngjyrat më të gëzuara të jetës,

Një petal me pika të freskëta vese mëngjesi, krijoi ujëvarën e pandërprerë të buzëqeshjeve,

Një petal buzëqeshjeje me gjithë zemër, derdhi plot nektar,

nga i cili u ushqyen e po ushqehen, pandërprerë qeniet tona...

Dhe të gjitha këto petale formuan lulen e MIQËSISË TONË TË ARTË!

Sa herë hapet një petal i Miqësisë,  
Shpirtërisht yjet në engjëj i kthen,

Parajsën gjithmonë në tokë e sjell,  
Magjinë hyjnore në dëshirë ta ndjell.

Sa herë hapet një petal i Miqësisë,  
Aroma e saj si nektar jete, shpirtra ushqen,  
Bashkë me ngjyrat me të bukura të jetës,  
Shkëndijat e shuara në shkëlqim të artë i rikthen.

Jeta nuk mund të të jap dhuratë më të çmuar, se sa bukurinë e përkryer të një miqësie të Artë!

Jeta nuk mund të japi dhuratë më të mirë se sa miqësinë e cila vendbanim ka Kopshtin e parajsës!

Nuk ka dhuratë materiale, pavarësisht vlerës së saj, që mund ta zëvendësoj dhuratën shpirtërore, atë më të çmuarën, që rrallë kush ka fatin e artë t'ia dhuroj Perëndia - MIQËSINË HYJNORE!

Miqësia është një dhuratë e privilegjuar prej së cilës njeriu e ndjen vetën të dyfishuar më të gjitha virtytet.

Miqësia e ARTË

Është Engjëlli që të mbron në vetmi,  
Është dera e hapur për jetë,

Është besimi reciprok i shenjtë!

Është zëri që të largon vetminë,  
Është Burim uji nëpër arrati,  
Është dora që shëron dhembje!

Është yll shprese, kur mendon se gjithçka është  
shuar;

Është hënë që të përkund në gjirin e saj, atëherë  
kur ke më së shumti nevojë;

Është diell që i jep shkëlqim shpirtit, kur  
mbërthehet nga hijet e errëta,

Është margaritari më i çmuar në të gjithë  
mbretërinë HYJNORE!

Miqësia e Artë ndërtohet nga petalet e luleve  
më të bukura ekzistuese që, së bashku, krijojnë  
Kopshtin e parajsës në tokë, në të cilin, njeriu ushqehet  
vazhdimisht me nektarin më të ëmbël të jetës; dhe i  
gëzohet pafund kësaj dhurate hyjnore, nga më të  
mrekullueshmet!

Miqësia e Artë zbrit nga lartësitë më të pastra  
hyjnore, prandaj i ngre gjithnjë lart në pedestal ata që e  
mbartin. Prej këtyre njerëzve bota zbukurohet e  
ndodhin mrekullitë!



Miqësia e Artë është buzëqeshje që e ndriçon tërë hapësirën e zemrës, është vesë mëngjesi e cila reflekton nën shkëlqimin e rrezeve të diellit, është melodi notat e të cilës arrin t'i lexoj vetëm ai që frymon në kopshtin e kësaj miqësie!

Mik i vërtet është dikush që e njeh melodinë e zemrës tënde dhe e këndon atë kur ti ta kesh harruar!... Dikush që të dhuron nektar jete sa herë që je i mërziur, dikush që të plotëson atëherë kur ti harron diçka, dikush që të kupton edhe kur ti heshtë!

Miqësia e Artë është si një kopsht përplot lule, në të cilin gjejmë qetësi shpirtërore dhe relaksim të këndshëm, sa herë që ndalemi aty për të pushuar!

Miqësia Hyjnore është si ajri: e nevojshme për frymëmarrjen dhe e domosdoshme për jetën.

Miqësia e Artë, ajo i ndriçon njerëzit mirëdashës, paqëdashës dhe ka burim ujëvarat e zellit shpirtëror.

Ne jetë nuk është vështirë të krijosh famë, tituj, pasuri... por është shumë, shumë vështirë të krijosh miq tek të cilët mund ta deponosh të sigurt besimin!

Ekziston një pamje më madhështore se sa qielli i kaltër: kjo pamje është Kopshti i Miqësisë së Artë ku gjithçka është origjinale dhe e pastër si kristali!

Miqësia është më shumë se një fjalë e thjeshtë. Mund të tentojmë ta përshkruajmë, por vetëm një komunikim maratonik me letra që transmetojnë mendime, ide, porosi brilante dhe të arta që jetojnë nëpër kohë, i japin kuptimin e drejtë dhe të mirëfilltë. Lum kush e përjeton këtë MIQËSI HYJNORE!

Miqësia... nuk është leksion që mësohet nga librat, as dhuratë që mund të ta falë dikush ose t'ia falësh dikujt, miqësia është mishërim i vlerave më të larta njerëzore që burim ka pastërtinë dhe ndershmërinë morale e shtrat rrjedhës ka gjuhen e kristaltë të ndjenjave, andaj edhe nuk përshkruhet me fjalë!

Kur shpërndajnë dritën e tyre dy miq të vërtet, atë hapësirë e mbulojnë rrezet më të ngrohta të shpirtit e zemrës... Aty shkrihet çdo copëz e akullit, e bashkë me të edhe çdo lloj hije gri. Aty valorizohen ngjyrat më të bukura, ngjyrat më të gëzuara, më madhështore të jetës, aty stacionohen buzëqeshja dhe gëzimi, aty bën follenë vetë BUKURIA HYJNORE!

Nëse ke një Kopsht të Miqësisë së Artë dhe një bibliotekë me dije hyjnore, ke gjithë nektarin që i nevojitet shpirtit!

Nuk besoj se ka diç më të vlefshme në këtë botë, që mund ta zbukuroj shpirtin, sesa kur e kupton se ekziston pranë teje një mik/esh i/e cili/a të ushqen për çdo ditë me nektarin më të ëmbël të jetës.

Një mik/esh i/e vërtetë është ai/ajo që është në gjendje të dëgjoj heshtjen tënde dhe, herë pas here, ta ndjej zhurmën e lotëve të tu kur është duke qarë zemra jote!

Rrezet e Miqësisë së Artë e shndrisin qiellin e shpirtit edhe atëherë kur aty mbretëron errësira e plotë!

Unë banoj në buzëqeshje... sepse ushqehem me nektarin e jetës!

Ç'është miqësia? Nektar jete që e përjetojnë dy shpirtra!

Një zemër e gëzuar (buzëqeshur) është padyshim rezultat i një Miqësie të Artë.

Gjithçka është e ngriset për një moment... kur befaz ardhja e një miku/eshe sjellë diellin. Ne fakt,

dielli ishte aty edhe më parë, por ajo perde e paarsyeshme trishtimi nuk na lejonte ta shihnim! Lumturia është pranë secilit prej nesh, mjafton të hapim zemrat dhe ta lejojmë diellin e jetës të shkëlqejë mbi ne.

Kur buzëqesh fytyra dhe zemra e mikut/eshës, buzëqesh edhe fytyra dhe zemra ime.

Për mirëkuptim reciprok nevojitet pak ngjashmëri; për një miqësi hyjnore nevojitet pak shkëlqim brilanti, e pak shtresë ari; për jetëgjatësi nevojitet shumë aromë dehëse e luleve të kopshtit... e këtu qëndron SEKRETI I ALKIMISË së një miqësie të tillë.

Miqësia e sinqertë është brilanti më i shkëlqyes i botës!

Nëse do ndalja kohën në pafundësi, gjënë e parë që do e bëja, të ruaja çdo ditë në përjetësi gjithçka të bukur nga miqësia që kam me ty!

Le të jetë miqësia jonë një fanar drite në det, kur ne të ndihemi të humbur në anijen me emrin JETË!

Çfarë të bën njerëzor?! Diçka që nuk mund të programohet. Është forca e zemrës njerëzore... Gjithçka

e mirë, e ngrohtë, e dashur, e pastër, shkëlqyese si BRILANTI... m'u ashtu si miku im.

Çfarë të bënë engjëllor?! Diçka që nuk peshohet me asgjë materiale... Është fisnikëria e pafund e një zemre dhe shpirti hyjnor... Gjithçka e ëmbël, e këndshme, e dashur, e buzëqeshur, e gëzuar, e lumtur... shkëlqyese si AR - m'u ashtu si mikësja ime.

Kur flet me gjuhën e mendjes të kupton secili, kur flet me gjuhën e zemrës të kuptojnë vetëm ata që arrijnë t'i dëgjojnë të rrahurat e saj!

Jo gjithmonë miqtë i shikojmë dhe vlerësojmë me mirë nga afër, edhe nga larg ndjejmë se janë të rëndësishëm në jetën tonë.

Largësia nganjëherë e bën miqësinë më të shtrenjtë... mungesa më të ëmbël.

Miqësia është kurora me e bukur e shoqërisë!

Miqësia e Artë është mishërim ndjesish mes dy genieve hyjnore!

Miqësia e Artë nuk mund të lind në shpirtira të zinj!

Miqësia nuk është vetëm një buzëqeshje në buzë, vetëm shkëlqim në sy..., por sinqeriteti në zemër.

E errët dhe e frikshme është rruga pa dritën e sinqertë të miqësisë!

Mik i veçantë është ai që sjell buzëqeshje kurdo që vjen dhe që lë ndjesi të këndshme sa herë që ikën.

**MIQËSIA E BEKUAR** është sikurse **ARI** - nuk e humb asnjëherë shkëlqimin e vërtet. Edhe nëse bie pak pluhur mbi të, vetëm me një fërkim të vockël, i kthehet sërish shkëlqimi, bukuria dhe madhështia hyjnore **SEPSE E KA URATËN E PERËNDISË!**

***Përgatitur nga: Vlora BANUSHAJ & Sabir KRASNIQI***



## NË KËTË VRAPIM JETE, MBËSHTETU NË BUZËQESHJE!

Sa mirë do të ishte ta krijojmë një „Ligj të Buzëqeshjes” në jetë! Një ligj me tepër se sa i mirë! Do të harkoheshin shumë ura mirësie, dashurie, bukurie, e nën këto do të rridhte pastërtia, dashuria, ngrohtësia shpirtërore dhe do e mbante gjallë dhe respektonte vetëdija e mirë njerëzore.

Mbështetu në BUZËQESHJE! Një nevojë e imja, por, jo vetëm e imja, besoj e secilës qenie njerëzore në këtë univers.

Buzëqeshja!

Sa herë që e dhurojmë dhe e marrim ndjemë shumë dallgë ngrohtësie, dashamirësie, e pastaj neve na mbetet që shpirtin tonë ta përkundim në këto dallgë jete, edhe pse jetëshkurtra, por tepër, tepër të këndshme. Gjithçka kur vishet me këtë ndjenjë të bukur krijon tërësinë e shijeve me plot ëmbëlsi mjalti.

Në shumë momente jete, edhe pse ndoshta në mënyrë jo shumë shprehëse, provohemi nga dy impulse të kundërta brendapërbrenda nesh në vazhdimësi: Në njërin anë, një çiltërsi e thellë, me e thellë se sa vet çiltërsia, e në anën tjetër, prireja për ta fshehë nga të tjerët atë gjendjen tonë të vërtetë shpirtërore që e përjetojmë në shumë situata jete, dhe atë me një



buzëqeshje. Shpesh këto i bëjmë për të mos e parë një lot të rrjedhë, për të mos e dëgjuar një thyerje, për të mos e ndjerë një dhembje pa zhurmë! Sa herë që në jetë gjërave ju falim pak më shumë besim, kur i trajtojmë me më shumë kujdes njerëzor, kur i dhurojmë më shumë kuptim se sa kohë, atëherë formësohen ylbere ndjesish nga më të këndshmet për t'u nisur me vrap drejt më të bukurës, më thelbësore së gjërave, drejt më të mistershmes, drejt më të pashpjegueshmes!

VULLNETI... po pra - vullneti, ai na mban të gjallë në këtë jetë! Ai bashkëpunon me SHPRESËN! I japin pulse jete veprimeve tona, e thellojnë gjakftohtësinë në momente tensioni, i japin fuqi vendosmërisë, këmbënguljes sonë për ta sfiduar jetën edhe atëherë kur pengohen dhe nuk përkrahen ndjesitë tona. Këtu pra, në vullnetin e mirë qëndron MADHËSHTIA, qëndron QETËSIA, qëndron DASHURIA...! Në vullnetin për të admiruar, adhuruar, simpatizuar, dashuruar, dhuruar, gëzuar, lumturuar njerëzit që na rrethojnë. Në vullnetin tonë të mirë që të dhurojmë dritë ma të ndritur se sa vet drita!!! Atëherë, vërtetë jeta do ta kishte emrin BUZËQESHJE!

Me këtë letër të pashkruar, por të lexuar nga unë në mendje, po vazhdoja të ecë rrugëve të qytetit tim e vetmuar... E vetmuar në ato orë të mbrëmjes. Iku edhe një ditë! S'po më lente rehat mendimi: jam lodhur! Ashtu edhe ndjehesha pastaj - e lodhur! „Ne jemi rezultat i asaj që mendojmë!” Ashtu e kam lexuar

diku në literaturën inspirative dhe është shumë e vërtetë kjo! Derisa ecja rrugëve të ndriçuara, në një moment gjithçka përreth u shkri në terr të plotë... ikën dritat! I gjithë qyteti im u pllakos nga muri i heshtjes. Ishte kjo tashmë rutinë e krijuar që sa vite me radhë, por unë po vazhdoja të ecja dhe nuk po vëreja asgjë. Në fakt, nuk kisha vërejtur asgjë përreth edhe kur hedhja hapat nën ndriçimin e dritave në rrugën e kaluar që sa vite! Gjithçka më parakalonte pa e vërejtur... Unë nuk isha aty në atë kohë - po mungoja në ato momente! Isha e harruar duke rikaluar nëpër copëzat e kësaj dite që iku në pakshim. Çka i dhurova kësaj dite që iku? Punë, përkushtim, seriozitet, respekt, pakëz ankth, shqetësim! Të gjitha këto! Po çka ndodhi me buzëqeshjen time? Çka?!

**Buzëqesha!**

I dhashë këtij momenti një buzëqeshje. E shkriva këtë moment në buzëqeshje. I dhashë emër! Buzëqesha në këtë vrapim jete. Pse mos ta kem si pushimore buzëqeshjen? U ndala të paktën për një moment nga ky vrap. Po si jam harruar në këtë vrapim?! Si, dhe pse nxitoj kështu dhe në këtë mënyrë?! Çdo ngjitje sjell ankth, shqetësim, stres... Atëherë pse i zgjedhim këto ngjitje shkallësh kur e dimë se atje lart gjejmë re ankthi të përziara me dromca e grimca stresi e pastaj do thellohet ftohja e ngjyrave... do rriten distancat? PSE? PSE? Apo ndoshta na tërheq gjithherë ajo e paarritura?! Gjithherë dëshirojmë ta

prekim të paprekurën, të arrijmë të paarriturën. Gjithherë jemi në kërkim të diçkaje, e asnjëherë të kënaqur me atë momentalen! E po, kjo është natyra njerëzore, apo qëllimi i vet jetës është që të kesh qëllim! Gjithherë jemi kërkues, sepse realizimi shpesh sjellë edhe ndjenjën e ngopjes, e kjo ndjenjë sjellë monotoni pastaj, andaj luftojmë, nxitojmë, vrapojmë të merremi me diç tjetër, të kërkujmë e të harrohemi në atë kërkim. **HARROJMË** se numërimi drejt perëndimit ka filluar që nga frymëmarrja e parë! Harrojmë se një ditë ne vet do të jemi të harruar nga vet harresa.

E di! E di se kam munguar edhe unë një kohë të gjatë! Kam qenë e pranishme diku tjetër me gjithë qenien time. Aty kam vërejt çdo detaj! Aty, në atë kohë, kam qenë plotësisht... e plotë, e koncentruar, e përkushtuar! Duke u munduar ta zgjidhë të ngatërruarën, ta vendos të pavendosurën, ta zgjidhë të pazgjidhurën, ta zvogëloj të akumuluarën... por, më duhet të them se edhe po vazhdoj të jem ende aty e pranishme. Atëherë, sigurisht se duhet të mungoj diku!

Po SOT ku jam?! Prapë filluan „llogaritjet”... prapë mendimet s’më lënë rehat!

Jam para një realiteti që s’e kisha pikturuar asnjëherë më ngjyrat e ëndrrave të mia Jam para asaj që të tjerët e dëshiruan, e larg asaj që unë e dëshirova. Mirëpo, një duhet ta di dhe e di: se NUK GUXOJ asnjëherë të humbas e të harrohem nëpër këtë vorbull jete, nëpër të cilën po kaloj, por duhet të vazhdoj, të

ngritëm mbi të, t'i bart kudo që shkoj ngjyrat ma të gëzuara të jetës e të shkoj në pikëtakimin tim me vijat, fjalën e bukur, ngjyrat, frymëzimin artistik - të mos e lë imagjinatën në letargji. Pikërisht aty është buzëqeshja ime, aty është frymëmarrja ime, aty takohem me hënën, yllin, diellin, lulen, ujëvarën, ylberin, nektarin.... me Shkëlqimin e jetës sime!

Epo çdo njeri në këtë vrap jete lidhet për diçka! Çdo lidhje kërkon energji. Por, për gjithë këtë energji, akumulim energjie, rigjenerim energjie, duhet më shumë kuptim, më shumë përkushtim, e jo më shumë kohë!

Kjo tingëllon sikur një zgjedhje. A zgjidhen gjërat me vet veprimin e zgjedhjes?! A e kam zgjedhur unë se ku duhet të mungoj, e ku duhet të jem e pranishme? Atëherë, kjo tingëllon si: Të zgjedhësh, është moszgjidhje njëkohësisht!!! Por, a mund të jem edhe KËTU edhe ATJE në të njëjtën kohë?! Prishet tërësia, apo?... Por, unë në fakt e kam bërë zgjedhjen! E kam bërë një kompromis: Atje veprojë me mendje, arsye... e këtu veproj me ndjenja!

Oh, Zoti im, Ti që me dashurinë tënde e mbush shpirtin tim, sa shumë kam nevojë për pak pushim, për pak paqe, për pak heshtje! Shumë ma shumë se sa shumë!

Në këto momente, vrapimi jete, nuk dua të dëgjoj as edhe një tingull zhurme! Dua të heshtë në heshtjen time, dua të jem vet paqja në paqen time, dua

## **IMAGJINATA VS**


---

të prehem në meditim, dua të nxitoj për të pushuar, dua të buzëqeshë në qeshjen e zemrën sime!

U takuam me buzëqeshje, e po ndahemi prapë me buzëqeshje.

O njerëz të mirë, mos harroni - **MBËSHTETUNI NË  
BUZËQESHJE, Ju lutem!**





## **MESAZH FESTIV!**

„Qeshuni nga thellësitë e shpirtit, më shumë se që merrni frymë, dhe dhuroni dashuri nga zemra, më shumë se sa të rrahurat e saj!“

Sikurse kristalet e pastra të fjollave të borës, që shkëlqejnë dhe i japin bardhësi natyrës, ashtu dëshirojmë që të shkëlqej dhe të jetë i bardhë, edhe universi shpirtëror i çdo qenie hyjnore që frymon në këtë hapësirë të madhërishe plot jetë.

Vetëm në atë shpirt, që shkëlqen si kristali, vetëm në atë shpirt, që është i bardhë si vet agimi, vetëm aty stacionohen dhe bëjnë folën edhe krijesat e ndritur engjëllore! E aty ku banojnë engjëjt, aty banon edhe buzëqeshja, aty rrjedh nektari më i ëmbël i ekzistencës, aty valorizohen ngjyrat më të bukura e më të gëzuara të jetës, aty është vet bukuria hyjnore - fryma më e pastër e dashurisë.

Aty ku mungon fryma e dashurisë, aty mos kërkoni bukuri, mos kërkoni shkëlqim, mos kërkoni bardhësi, mos kërkoni engjëj, mos kërkoni parajsë! Aty do të gjeni vetëm errësi, klithma demonësh, frymën e shëmtisë - ferrin vet! Bukuria është reflektim i



dashurisë - shëmtia, reflektim i urrejtës! Ai që ka të kultivuar në shpirt dashurinë, gjithçka që bën, e bën me dëshirë dhe kënaqësi, e gjithçka që ndërtohet nga këto ndjesi të pastra, shkëlqen nga bukuria! E kur shpirtit i mungon dashuria, edhe brilanti më i çmuar i botës, të duket i shëmtuar! Po të mbizotëroj më shumë dashuri mes njerëzve, a do të kishte hapësirë aty urrejtja?... E urrejtja është shëmtia më e madhe e jetës, që gjeneron vetëm xhelozë, mosmarrëveshje, përçarje, dhunë, konflikte..., MJERIM!

Andaj, le t'i hapim portat e universit shpirtëror, dhe ta mbushim këtë hapësirë me shkëlqim e bardhësi, me tingujt e përsosur të ritmit hyjnor, me aromën dehëse nga kurora lulesh me ngjyra magjepse. Le ta freskojmë këtë hapësirë me ujëvara buzëqeshjesh, që burim kanë thellësitë më të pastra e më të çiltra të zemrës. Le të mbjellim çdo ditë nga një filiz të ri, dhe mbi këtë sipërfaqe të ndërtojmë Kopshtin më madhështorë të jetës - KOPSHTIN E PARAJSËS! Kopsht nga i cili do të ushqehemi përherë, vetëm me nektar...! Le të pikturojmë në këtë hapësirë harkore ylberesh me ngjyra dashurie, sepse vetëm me dashuri mund të ndërtojmë ura lidhëse, ura që i afrojnë shpirtat, që i bashkojnë njerëzit, që lidhin shoqëritë, ura që mposhtin urrejtjen, venitin meritë, pengojnë zemërimet, frenojnë djallëzitë, ura që sfidojnë çdo


shëmti, dhe mbi to murosën bukurisë e përkryera të jetës.

Të kultivojmë vetëm farën e dashurisë - frymën hyjnore, në të gjithë hapësirën e këtij Kopshti parajsorë, që frutat e saj t'i ndjejmë, t'i shijojmë, t'i përjetojmë, gjatë gjithë viti që po vije... edhe viteve në vazhdimësi dhe këtë frymë, këtë aromë të këndshme, këta tinguj të ëmbël skofiar, këto ngjyra nga më të gëzuara të jetës, përmes harkores së ylberit, t'i bartim edhe tek syri, zemra dhe shpirti i të gjithë të dashurve tanë, të gjithë njerëzimi sepse dashuria është shpresë, dashuria është frymëzim, dashuria është motiv, dashuria është solidaritet, dashuria është mirësi, dashuria është mbarësi, e mbi të gjitha, dashuria është perlë e lumturisë!

Urojmë që kjo perlë e lumturisë ta stolisë zemrën e secilit nga ju - zemrat e gjithë njerëzimit!

**GËZUAR!**

***Vlora BANUSHAJ & Sabir KRASNIQ***



## NË ÇDO FRYMËMARRJE JETE...

O dallgë të detit! E di se ju e nuhasni shumë mirë heshtjen time, disponimin tim në këto momente, por këtu erdha t'ju shijoj, t'ju përqafoj, andaj edhe ashtu do të veproj. Do ta hedhë tej në det atë buzëqeshje të ngrirë që ngjau që në minutat e parë kur arrita në këtë qytet bregdetar... dhe përsëri në buzët e mia do të çel buzëqeshja ime ashtu edhe si u nisa me të. Unë tash dua të buzëqeshë jo vetëm për vete - pse-n vetëm unë e di! Këtë dua ta bëjë, sepse vetëm atëherë ndihem e plotësuar, e përmbushur. Të lutem, buzëqeshë - jehonë magjishëm refreni i melodisë hyjnore, sepse kur buzëqeshë Ti, buzëqeshë edhe Unë! Dhe fytyrën time ma përkëdhelë një buzëqeshje e lehtë.

Dhe prapë këtu, e ulur pranë jush, me ju... E strehuar në këtë magji jete, e mbështjell me këtë freski ajri, e tretur në këtë tingull të magjishëm përplasje dallgësh, dua ta them atë të pathënën! Dhe për një moment më duket se qielli është binjakëzuar me detin - janë shkrirë në një! Më duket sikur çdo valë e detit është e qëndisur me nga një yll, e në mes qiellit dhe detit, shtrin bukurinë e saj hëna - ma e bukur se sa vet bukuria.

Duke e soditur këtë pamje e përjetova atë ndjenjën e ngrohtësisë që e merrja sa herë e ndjeja një

ngjashmëri ndjenjash tek një qenie hyjnore! M'u sikurse një tërësi e shijeve të jetës... Gjithçka më duket madhështore në këtë Univers.

Të përqafoj o thellësi e pafund,

Të përqafoj o pastërti e pafund,

Të përqafoj Lumturi e pafund!

Të dua, të dua, të dua... BUKURI E PËRKRYER JETE! Të ndjejë me dritat më të përzgjedhura, me ngopje të pangopshme... Dhe, më besoni, derisa i thashë këto, derisa i shqiptova këto fjalë për t'i shpërndarë në këtë univers, m'u dukë se nga unë u lirua një energji e madhe, energji që shumëfishon këtë ndjenjë dhe e bënë edhe me të thellë, edhe më hyjnore dhe të përjetshme, pavarësisht stuhive eventuale në kthesat e jetës.

Ah, më falni një moment, duhet ta ndërpres këtë vargëzim ndjenjash!

U ktheva përsëri! M'u dashtë ta dërgoj nga këtu një fjali larg, por, sa larg aq edhe afër! E nisa në një vijë shpirtërore që e njohim vetëm unë dhe një qenie hyjnore! ...Dhe papritmas ndjej mall! Heshtje! Heshtje zëri, por flet malli me gjuhën e ndjenjave.

Si gjithmonë, jemi prapë në çdo frymëmarrje, në çdo përplasje valësh, në çdo buzëqeshje... jemi ngjitur në majën e bukurisë sonë të përkryer të jetës.

Buzë detit jam duke e shijuar këtë fresk veror por, edhe këtu, edhe kudo që shkoj, me vete e bartë „Mbretërinë e Trëndafilave“, se kjo është pjesë e imja!

Aty ku trëndafilat një ditë vere ju përgjigjen me zë thirrjes së Jetës. Ju përgjigjen kësaj thirrjeje, sepse aty tanimë ishte çdo gjë e qartë, më e qartë se çdo rreze drite!!! Dhe në këtë rrjedhë jetësore u deponua gjithë kristali i universit shpirtëror, për të nxjerrë pastaj nga ai burim i pashtershëm, ujëvarë ndjesish nga më të kulluarat, më të çiltrat. Realiteti ja ka marr magjinë ëndrrave!!! Hyj e strehohem në këtë Mbretëri... harrohem e tëra! Harroj se ka edhe diçka tjetër jashtë portave të mbretërisë dhe, për çudi, aty edhe koha nuk më lajmërohet! Hy brenda brendisë sime, brenda qenies sime. Lëvizë lehtas e më shumë dashuri duke hedhë hapat nëpër tingujt e ëmbël të melodisë që din t'i thurin vetëm zemrat me notat e tyre, dhe nën tingujt e asaj melodie shpërndahet lehtas një aromë e këndshme. Sa më vije si aromë e trëndafilave, e sa më ngjan si aromë luleshtrydhesh, e herë-herë, e harkuar si dy qershiza të ëmbla shumë. Aty e gjejë Mjaltin e shpirtit tim, këtë ëmbëlsi që e shtreson çdo fije shpirtërore time me nektar! Qëndrueshmëri, përjetësi... këto ndjehen!

Udhëtoj e udhëtoj drejt substanciales, se vetëm kështu e ndiej tërësinë. Nuk dua të nisem në atë drejtim ku një pjesë gjithëherë duhet të vihet në hijen e dyshimit, prandaj, udhëtoj rrugëve të cilat i njeh vetëm zemra. Aty marr frymë, aty marr jetë, aty i dëgjoj tik-taket e saj... aty jam unë ajo që jam - e panjohur për jashtësinë por, shumë e vërtetë - ORIGJINALE për brendësinë time.


Çdo zgjim jete ka shumë ëmbëlsi, ngrohtësi... Një fjalë, një rresht, një varg, një buzëqeshje që më vije, e stolisin atë zgjim. Në mesditë shumë vezullima ndjesish, e deri sa t'i mbyll sytë unë udhëtoj..., por jo e vetme në vijën tonë shpirtërore, për ta vazhduar me pas takimin në atë magjinë e ëndrrave. Eh, ata që nuk arrijnë ta kuptojnë këtë udhëtim timin, vazhdojnë të me bëjnë pyetje shpesh - pa kohë e pa vend. E që s'do e marrin përgjigjen asnjëherë. Se për ta marr një përgjigje, ndoshta këtu duhet edhe të mos pyesin. E si t'u përgjigjem unë kur shumë herë sytë thonë më shumë se sa fjalët?! Por, këtë përgjigje arrin tak kap vetëm një qenie hyjnore që e lexon edhe shikimin tim! E për ata të tjerët, vetëm mund të them, se kanë mbet në kufijtë e të dukshmes, brenda kornizave të sipërfaqësore...

Dhe krejt në fund, dua t'ju them edhe një fjali:

**FALEMINDERIT MADHËSHTI, PËR KËTË  
BUKURI TË PËRKRYER JETE QË MA DHUROVE!**







## ÇASTI...

Ishte, po ashtu, një çast, kur ti ke ardhur në këtë botë!

Derisa ti ke ardhur duke qarë,  
të gjithë të tjerët rreth teje, kanë buzëqeshur të gëzuar.

Vazhdo të jetosh ashtu...,

Që kur të vijë çasti, që ti të ndahesh nga kjo botë,  
të ndahesh me buzëqeshje,  
e tjerët rreth teje të qajnë!

Në jetë, nuk është e rëndësishme se cilës rrugë nisësh,  
e rëndësishme është që të arrish me kohë në cakun e  
synuar.

Mos shiko në bukuri, sepse ajo është mashtruese!  
Mos vrapo pas famës, sepse ajo është kaluese,  
Mos shiko në pasuri, sepse edhe ajo është shteruese.

Kërko dikë që di të të bëjë të buzëqeshësh,  
Gjej atë që e bën të qeshë zemrën tënde,  
pasi njeriu më i bukur është ai që sjellë buzëqeshje  
kurdo që vjen!

Mjafton vetëm një buzëqeshje e tij,

për ta kthjelluar qiellin e universit tënd nga çfarëdo lloj vranësire.

Çdo e qeshur me zemër  
është një gur më shumë në muret e urës që ndërtojmë,  
përmes së cilës,  
një ditë,  
do të arrijmë t'i (mbi)kalojmë edhe greminat e  
vuajtjeve.

Shumë njerëz kalojnë nëpër shtigjet e jetës sonë,  
por vetëm ata më të rëndësishmit, më të veçantit...,  
arrijnë të lënë gjurme të Arta që shkëlqejnë  
përjetësisht!

Jeta s'ka ndonjë tjetër kuptim,  
përveçse atij (kuptimi) që i japim ne vetë!

Jeta është vijë...,  
ngjyrën e te cilës e shohim sot,  
ndërsa ngjyrat që dëshirojmë t'i shohim  
i pikturojmë në galerinë e shpirtit.

Njeriu nuk bëhet i lumtur duke arritur gjërat me vlerë,  
por duke arritur ato që ia kërkon dhe dëshiron zemra.

Është e vërtet,

që ne, ndonjëherë nuk dimë ta vlerësojmë atë që e kemi,  
derisa nuk e humbim!

Është, po ashtu, e vërtet,  
që ne ndonjëherë nuk e dimë çfarë na mungon,  
derisa ajo nuk na nevojitet!

Në jetë zgjedhim rrugë të ndryshme por,  
pavarësisht se ku shkojmë,  
me vete marrim edhe një pjesë nga tjetri!

Në jetë ka çaste,  
kur ti ke aq shumë nevojë për dikë,  
sa që mundohesh ta nxjerrësh edhe nga ëndrrat,  
për ta pasur sa më pranë...,  
për ta përqafuar pafundësisht!

Për t'i arritur majat e larta, duhet përpjekje, energji,  
fuqi...,  
por edhe zgjuarsia dhe, natyrisht, ndonjëherë edhe pakëz  
fat.

Që ta arrish brendinë e zemrës,  
vetëm duhet trokit me dashuri në derën e saj!

Edhe nëse njëra derë e fatbardhësisë është e mbyllur,  
tjetra është e gatshme përherë për t'u hapur.

## IMAGJINATA VS

---

Shumë herë qëndrojmë gjatë para dyerve të fatit,  
dhe pikëllueshëm shikojmë në to...!  
E nuk marrim guximin për një çast,  
që ta shtypim dorezën e derës!

Kush e shtyp, atij edhe do t'i hapet,  
Kush kërkon, ai edhe do të gjej,  
Kush përpiqet, padyshim, edhe do të ngadhënjej!

Të dorëzohesh është rruga më e lehtë drejt dështimit.  
Të përpiqesh kërkon sakrifica, por je përherë  
ngadhënjimtar!

Ne jetë nuk është vështirë të krijosh famë, tituj, pasuri...  
por është shumë, shumë vështirë,  
të krijosh miq tek të cilët mund ta deponosh të sigurt  
besimin:  
Miq që, përmes buzëqeshjes, të sjellin dashuri...  
Miq që, përmes gëzimit, të sjellin lumturi...  
Miq që ta zbukurojnë vazhdimisht jetën!

Lumturia është pranë secilit prej nesh,  
Mjafton vetëm të hapim zemrën  
dhe ta lejojmë diellin e jetës të shkëlqejë mbi ne!

Ëndërro për atë që dëshiron të ëndërrosh,  
Nisu andej kah dëshiron të shkosh,  
Bëhu ai/ajo që dëshiron të jesh.

... për atë, sepse ke vetëm një jetë!

Në rrugëtimin jetësor ushqehu çdo çast me dashuri,  
për të qenë i lumtur...

Mos i humb për asnjë çast shpresat,  
për t'i realizuar ëndrrat e tua.

Njerëzit e lumtur, në të vërtet,  
nuk e posedojnë përherë ajkën e së bukurës,  
por ata vet gjithçka e bëjnë të bukur!

Jeta nuk matet me sekonda,  
por me çaste... çaste që mbetën në përjetësi!

Prandaj,  
dhuroju çaste të këndshme:

Njerëzve që kanë ditur  
të falin buzëqeshje në buzët e tua;

Njerëzve që kanë arritur  
të krijojnë ngrohtësi të pafundme në zemrën tënde;

Njerëzve që të kanë ditur  
të nxisin shkëlqim gëzimi në sytë e tu;


Njerëzve që kanë arritur  
të mbjellin fidanë lumture në shpirtin tënd;

Njerëzve që kanë ditur dhe arritur,  
bashkë me ty,  
të ndërtojnë Kopshtin e parajsës:  
**BUKURINË E PËRKRYER TË JETËS!**

*Përgatitur nga: Vlora BANUSHAJ & Sabir KRASNIQI*







## MONOLOG

Një fjalë, një fjali, një copëz rrëfimi më shtyjnë, më zhysin drejt e në vorbullën e pafund të dhembjes sime. Unë bëhem vet dhembja. Në mes meje dhe dhembjes mbetet kjo e fundit triumfuese. Më nuk arrij ta shohë unë atë, por ajo mua më shikon, si për ironi, nga një lartësi e konsiderueshme. Dhembje pa zë, dhembje në heshtje... e fshehur, e struktur, e ndrydhur. Një dhembje që dhemb më shumë se çdo plagë tjetër dhe që të përcjell në vazhdimësi.

Monolog! Por, edhe ky monolog pa zë. Sa pyetja, por edhe këto pa përgjigje. E pas tij vijmë lutjet, po ashtu të thëna në heshtje -pa zë, pa zhurmë. Shpesh duke mos i dëgjuar fare ato që zhurmojnë rreth meje. Një dëshirë lind brenda për një fuqi mbinatyrore, për t'i ndryshuar gjërat në të mirë. Dëshirë për t'u zgjuar nga kjo ëndërr e keqe që po merr pafund gëzimet, lumturinë, harenë, buzëqeshjen, këngën tonë... Por, në fund mbetet mendimi se, ne jemi vetëm njerëz me këto pak shqisa që ndjejmë, prekim, shohim... dhe nuk mund ta bëjmë të pamundurën që shtrihet jashtë mundësive tona, përkundrejt dëshirës sonë tejet të madhe.

Të shikoj çdo ditë se si të shuhej jeta dalëngadalë në sytë e tu. E fsheha lotin nga Ti babë. E mbulova dhembjen. I palosa kujtimet për t'i ruajtur me


kujdesin ma të madh. Ti ike nga ne me buzëqeshjen, dashurinë, ngrohtësinë, bujarinë, universin e pafund të dijes që e kishe akumuluar me vite të tëra. Nuk mund ta shikoja as këndin tënd të leximit... Nuk mund t'i shikoja më as librat, ato që aq shumë i deshe. Mbeta unë, por edhe ato mbeten në heshtje. Ngeci fjala në fyt. U ngri buzëqeshja! Të gjithë u mbështollëm në heshtje. Në heshtje, se iku në një dimension tjetër jete ai që u mishërua aq shumë me to. Iku ai që me aq shumë kënaqësi i lexonte shkrimet e mia... edhe tash ti i lexon, unë e di!

Sa shumë e deshe jetën! Por as vdekjes nuk ju frikësove aspak, sepse kush me mirë se ti e kuptoi se ky është vetëm një proces, një kalim në një energji tjetër, përmbajtje tjetër, formë tjetër...!

Atë ditë erdha të përshëndetem me ty, aty ku tash ti pushon përjetësisht. Duhej të kthehesha prapë aty nga ku kisha ardhur. Isha mësuar të të përqafoja me mallin që pikonte aty tek stacioni i ndarjeve për t'u zhdukur në qiellin e pafund me re... Por, tash kjo përshëndetje ishte pak më ndryshe. Për një moment më është dukë se u përmbys qielli me re dhe dheu më rrëshqiti nën këmbë. Pikat e shiut u përziën me lotët e mi. Më mirë kështu, thash me vete! Nuk dua as tash të ma shohësh lotin në sy. Nuk po qaj jo! Janë ca pika shiu... Nuk dua të më shohësh të mërzitur, ashtu siç nuk më ke parë as edhe në momentet më të vështira, aty me ty, pranë teje. Por, të premtoj, se nuk do të rresht së

shkruari, sepse e di shumë mirë sa shumë ti e deshe fjalën e shkruar.

Andaj, pusho i qetë i pavdekshmi ynë BABA!



## HIJE NË SHPIRT

Ky moment jete derdhi hije trishtimi në shpirtrat tonë dhe këto hije po më përcjellin në çdo gëzim, buzëqeshje, përjetim... duke e zbehur çdo gjë. Gjithçka ka rënë nën hije edhe pse duket shpesh se vezullon nga jashtë.

Babë, më fal, se lotin nuk mund ta ndalë. Kam shumë mall për ty. Për zërin tënd. Për afërsinë tënde. Për fjalën „qika jeme“.

Sa do të dëshiroja veç edhe një herë te të takoja e të bisedonim gjerë e gjatë, herë të qeshnim e herë të përplaseshim me koncepte, ide...

Në momentet kur kaplohem e tëra nga malli, i afrohem librave. Aty më duket se e shohë fytyrën tënde. Buzëqeshjen tënde. Aty gjendet edhe Ditari yt. Por, ai më nuk është shfletuar. As edhe pas dy viteve nuk kam forcë ende ta shfletoj. Vetëm e shikoj, e përkëdhelë me shikim e më mall. Kam frikë, shumë frikë, se kur ta prekë, e ta shfletoj, mos do të rrëshqet ndonjë nga lotët e mi të shumtë dhe padashur do ta shlyejnë ndonjë shkronjë, presje, pikë nga aty e do ta largojnë aromën e duarve tua. Dua ta ruaj si thesarin dhe kujtimin më të bukur nga Ti, këtë Ditar që mbaje më aq shumë kujdes e rregull, sepse Ti je aty, mu në mes atyre rreshtave, fjalëve, fjalive, shkronjave. Aty

është energjia jote, aroma jote, shkrimi yt, mendimi yt, zëri yt, vula jote... shpirti yt!

Babë, më fal edhe për buzëqeshjen time të zbehur. Iku dielli i shtëpisë sonë. Ranë hijet. Hije që shpërndajnë shumë acar në shpirt. Asgjë më nuk duket më e bukur siç dukej në kohën kur dielli e mbushte shkëlqim shtëpinë dhe shpirtrat tonë.

Ti ike për të mbetur i përjetshëm!

Mbete një shembull për gjeneratat në vijim, për mbesat e nipat që nuk patën fatin të takohen me ty, siç nuk e pata fatin as unë të takohem me gjyshin tim - urtakun e madh e të mençur. Mbetesh simbol i dijës, i durimit, i fjalës së ëmbël, i respektit, i humanitetit, i njerëzores dhe i tolerancës.

Po ku e gjeje gjithë atë forcë shpirtërore t'i qëndroje aq qetësisht fundit dhe përshëndetjes me ne? Ti shumë mirë e dije se edhe pak do të qëndrosh në mesin tonë. E dinim edhe ne! Nuk dorëzoheshe assesi! Buzëqeshja të përcolli edhe në momentet me plot stuhi kur jeta dhe vdekja ishin afruar më shumë se kurrë me njëra-tjetrën... në momentin kur po i numëroje minutat e fundit! Po si pate forcë dhe vullnet ta dëgjosh edhe këngën tënde të preferuar, pak para se të ndaheshim! Ne luftonim për ta fshehur këtë dhimbje para teje e ti, me atë qetësinë tënde të thellë, e dëgjove dhe ike atë ditë të hënë.

Shpirti yt ishte një melodi, andaj, deshe më këta tinguj melodie të përshëndeteshe me ne...


Është vjeshta e dytë në jetën time që nuk i pashë gjethet e zverdhura në Kosovë.

Edhe këtë vjeshtë nuk jam afër, aty ku pushon ti. Por, nga kjo largësi fizike, unë jam shumë pranë me Ty, në çdo kohë! Lutem për TY, për shpirtin tënd të bardhë. Lutem të pushoj shpirti yt i qetë.

Të kujtojmë përjetësisht me plot dhimbje e krenari, ty Mendjendrituri jonë, i pavdekshmi jonë!

*4 Dhjetor 2017*





## NË PRAG TË VITIT TË RI, U ULA DHE SHKROVA

Shkova pranë dritares ku zakonisht mbështetëm kur e ndjej se duhet të pushoj pakëz, dhe ashtu e heshtur shikoj. Fjollat e kristalta të borës binin lehtas në tokë, ngadalë dhe pa u ndier. Ashtu heshtas mbështjellin gjithçka me bardhësi. E ftohtë, e akullt kjo pamje...! Me çdo fjollë bore që bie, më duket se thellohet e më mbështjell edhe më shumë ky akull brenda shpirtit tim. Dimri ka zbritur! Dimër në çdo skutë të shpirtit!

Janar, shkurt, mars, prill, maj, qershor, korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor dhe tash jemi në muajin dhjetor. Kështu po i rinumëroja në mendje edhe një herë muajt - muajt e këtij viti të mbrapsht! Duke e ndjekur shprehinë time, në prag të çdo Viti të Ri, unë ulëm sërish dhe i hapë shtigjet e mendjes, i shpupurisë copëzat e kohës, i kapë momentet më të gëzuara apo më të trishtuara që i kam kaluar gjatë muajve të kaluar. E prapë tash, kur jam ulur m'u në prag të këtij viti, po i kërkoj ato çaste! Dhe pyetja e radhës është: A kishte më shumë rreze dielli apo copëza akujsh?! Kishte më shumë vranësira, apo mjegull?! A piku ndonjë copëz ëndrrë, apo ra në dremitje më të thellë?! Çfarë afirmimesh i kisha dhënë ndërdivjes sime?! Më ishte

ngrirë loti në qerpikë, apo buzëqeshja kishte shndritur?! Sa stinë i kishte viti 2017? Apo i gjithë viti ishte vetëm një stinë?!...

E tash ky muaji i fundit ma dha përgjigjen: Viti 2017 më solli vetëm stinën e dimrit!

Rikthehem për pak çaste prapa në kohë... Dhe, para se të fillojë këtë udhëtim nëpër shkallët e kohës, marr frymë thellë dhe për një moment kam përshtypjen sikur me ndalet fryma dhe s'kam më forcë të hedh hapa më tej!...

Viti 2017 ishte vazhdim i një betejë të vështirë me jetën -betejë që kishte filluar një vit më parë. Këtë betejë po e bëje ti baba...! Nuk ishte i vetëm, prapa na kishe neve.

Muaj mars - muaji i vendtakimit të dimrit me pranverën! Përshëndeten duke ia lëshuar radhën njeri-tjetrit por, tek unë, tek ne, mbeti vetëm një stinë, ajo e dimrit.

Jeta është sprovë!

Nuk është e thënë gjithherë të nisesh me buzëqeshje dhe të kthehesh me buzëqeshje. Me dimër në shpirt shkova dhe erdha - kështu po i bëja udhëtimet e mia.

Muaji prill dhe muaji maj solli shumë pritje, drithërima, ankthe, ëndrra, shpresa, kureshtje. Po lexoja çdo rresht... doja ta përpija çdo lloj informacioni në lidhje me këtë të keqe që po përpinte dhe po merr çdo ditë jetë njerëzish. Pak buzëqeshje, shumë pak... shumë

pak gëzime... shumë pak ngjyra të gëzuara. Lot me shije të hidhur... Përpjekje për ta fshehë mërzinë...!

Gjithë këto copëza të mërzisë, dhembjes... që më kishin goditur i mora me vete.

Në muajin shtator gjethet e shpresës po zverdheshin çdo ditë dalëngadalë dhe binin lehtas në shpirt. Gjithçka po zbehej, vullneti, buzëqeshja..., mendimet po më frikësonin! O sa do të dëshiroja të ishte kjo vetëm një ëndërr e keqe! Por jo, ishte një realitet me ngjyra të ngrysur.

Dhe tash erdha këtu - në muajin dhjetor! Dhe çfarë mund të them për këtë muaj, për këtë vit?! Muaji dhjetor solli më shumë se kurrë acar e ngrica në shpirt. Beteja mori fund, ngadhënjeu ajo me e keqja! U shua një jetë, pushoi së rrahuri një zemër e madhe, iku në amshim një mendje e ndritur, një univers dijesh...

Ne mbetëm pa buzëqeshje, me lot në sy e me vaj në buzë. Dhembja na pllakosi...

Por, dhjetori nuk u mjaftua me kaq - ai e mori edhe një jetë tjetër. Edhe një goditje e madhe. Dhembja rëndon sa një bjeshkë. Ajo tashmë flet. Ajo është këtu rreth nesh, mes nesh, kudo. Me të zgjohemi e më të ikim për në gjumë...!

Nuk kam pas dëshirë asnjëherë që penda ime të ngjyhet në lot e mërzi, dhe më këto ngjyra ta filloj një shkrim...

O sa shumë kam mall për TY babë. Sa shumë kam nevojë të bisedojë me ty dhe të marr mendimin

tënd, pëlqimin, kritikën për rreshtat që i shkruaj. E di si të quaja ty? - Enciklopedi e gjallë! Por tashmë ka rënë heshtja në mes nesh. E unë pres, pres..., e duke pritur pika malli pikojnë çdo ditë në shpirtin tim.

Dhe çfarë të them krejt në fund të kësaj faqe të jetës: Gjatë gjithë këtij viti u mundova t'i japë forcë vetës, për të të dhënë forcë edhe ty që më shumë se kurrë kishe nevojë për të.

Babë, më nuk mund ta dëgjoj këngën tënde të adhurar, të cilën e dëgjove pak momente para se të ikësh në amshim. Më nuk mund as të këndoje sepse dua ta ruaj me fanatizëm kujtimin e momenteve kur te dy, unë e ti, e kënduam këngën tënde. Ti sikur e parandjeve se orët e tua ishin të numëruara dhe doje me këngë të përshëndeteshe me ne. Nuk u dorëzove as edhe një moment.

Andaj, unë me këtë vit po ndahem shumë e mërzitur, dhe po ashtu me lot do ta përqafojë edhe Vitin e Ri 2018!

*Kreuzlingen, 30.12.2017*

## **PËRMBAJTJA**

**„GJEOGRAFIA LETRARE“ E VLORA BANUSHAJ KRASNIQI 5**

---

---

**REFLEKSION 9**

---

---

**NË PRAG TË VITIT TË RI, U ULA DHE SHKROVA... 23**

---

---

**NË MBRETËRINË E TRËNDAFILAVE! 29**

---

---

**UDHËTIM NË VIJË KOHORE 35**

---

---

**KOPSHTI I MIQËSISË SË ARTË 41**

---

---

**PARA PASQYRËS SË JETËS 47**

---

---

**THËNIE TË ARTA PËR MIQËSINË 53**

---

---

**NË KËTË VRAPIM JETE, MBËSHTETU NË BUZËQESHJE! 63**

---

---

**MESAZH FESTIV! 71**

---

---

**NË ÇDO FRYMËMARRJE JETE... 75**

---

---

**ÇASTI... 81**

---

---

**MONOLOG 89**

---

---

**HIJE NË SHPIRT 93**

---

---

**NË PRAG TË VITIT TË RI, U ULA DHE SHKROVA 97**

---

---

**PËRMBAJTJA 101**

**Vlora Banushaj Krasniqi**

**IMAGJINATA VS**

**Përgatitja kompjuterike:  
Sabir Krasniqi**